


ROLI I PARLAMENTIT NË POLITIKËN FISKALE PËR SITUATA EMERGJENTE:

Mësime të nxjerra për planifikimin në situata emergjente



Raport nga
Partneriteti për demokraci
i Dhomës së Përfaqësuesve
dhe Agjencisë Zvicerane
për Zhvillim dhe
Bashkëpunim

Hulumtuar dhe
përgatitur nga
Krisztina Csillag,
David Pechefsky,
Kevin Deveaux
dhe Tim Baker


ROLI I PARLAMENTIT NË POLITIKËN FISKALE PËR SITUATA EMERGJENTE:

Mësime të nxjerra për planifikimin në situata emergjente

Raport nga Partneriteti për demokraci i Dhomës së Përfaqësuesve dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Hulumtuar dhe e përgatitur nga Krisztina Csillag, David Pechefsky, Kevin Deveaux dhe Tim Baker



 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTËTJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE





Ky raport është përgatitur nga Krisztina Csillag, David Pechefsky, Tim Baker dhe Kevin Deveaux përmes Partneritetit për demokraci të Dhomës së Përfaqësuesve (HDP), me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe programim nga Instituti Nacional Demokratik (NDI). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Partneritetit për demokraci të Dhomës së Përfaqësuesve (HDP), Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ose Institutit Nacional Demokratik (NDI).

PËRMBAJTJE

Lista e akronimeve të përdorura	<u>4</u>
Rreth partnerëve të raportit	<u>5</u>
Përmbledhje ekzekutive	<u>6</u>
I. Hyrje	<u>8</u>
Historiku	<u>8</u>
Qëllimet e punimit kërkimor	<u>9</u>
II. Përcaktimi i politikave fiskale dhe monetare dhe masat e rimëkëmbjes ekonomike	<u>10</u>
Politika fiskale	<u>10</u>
Politika monetare	<u>13</u>
Masat e tjera	<u>14</u>
III. Bërja e politikave fiskale gjatë një situatë emergjente	<u>16</u>
Miratimi i buxhetit	<u>16</u>
Shfrytëzimi i procesit të buxhetit kombëtar për të vendosur financimin e emergjencave	<u>17</u>
Konsiderata të rëndësishme në miratimin e dispozitave buxhetore në raste emergjente	<u>17</u>
IV. Mbikëqyrja parlamentare në kohë të krizës	<u>19</u>
Pasqyrë e mjeteve për mbikëqyrje parlamentare	<u>20</u>
Komisionet si një mjet kritik në mbikëqyrjen efektive	<u>20</u>
Zyrat dhe agjencitë e mbikëqyrjes	<u>22</u>
Qasja në kapacitetin e shoqërisë civile për të kryer mbikëqyrje	<u>24</u>
Përdorimi i teknologjisë për të promovuar mbikëqyrjen	<u>25</u>
V. Ndikimi gjinor	<u>27</u>
Shtojca 1: Lista kontrolluese e çështjeve kryesore që duhet të shqyrtohen	<u>30</u>
Shtojca 2: Udhëzime për parlamentet gjatë një krize fiskale	<u>33</u>
Shtojca 3: Studime të zgjedhura të rasteve: Kenia dhe Indonezia	<u>35</u>

LISTA E AKRONIMEVE TË PËRDORURA

APR	Shkalla vjetore e përqindjeve (për kreditë)
ECPRD	Qendra Evropiane për Hulumtime dhe Dokumentim Parlamentar
BE	Bashkimi Evropian
VF	viti fiskal (tetor 01-shtator 30)
HDP	Partneriteti për Demokraci i Dhomës së Përfaqësuesve (Kongresi i SHBA-ve)
HOR	Dhoma e Përfaqësuesve (Kongresi i SHBA-ve)
IPF	institucionet e pavarura financiare (të krijuara pas Krizës financiare globale të 2007)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
LAC	Rajoni i Amerikës Latine dhe Rajoni i Karaibeve
LGBTQI +	Lesbikë, homoseksuale, biseksuale, transgjinitore, queer, ndër-seksual
MENA	Rajoni i Lindjes së mesme dhe i Afrikës së veriut
Eurodeputet	Anëtar i Parlamentit Evropian
Deputet	Anëtar i Parlamentit
NDI	Instituti Nacional Demokratik për çështje ndërkombëtare
PBO	Zyra e buxhetit parlamentar
PMP	Pajisje mbrojtëse personale
PAK	Persona me aftësi të kufizuara
RR	Rregulloret
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

Partneriteti për demokraci i Dhomës së Përfaqësuesve (HDP): Misioni i Partneritetit për demokraci i Dhomës së Përfaqësuesve është të punojë me vendet në mbarë botën dhe të promovojë qeveri të përgjegjshme, efektive dhe të forcojë institucionet demokratike. Thelbësore për punën tonë është bashkëpunimi ndërmjet kolegëve për të ndërtuar ekspertizë teknike në legjislaturat partnere që do të rrisë përgjegjësinë, transparencën, pavarësinë legjislative, qasjen në informacion dhe mbikëqyrjen e qeverisë. HDP aktualisht ka partneritet me më shumë se 20 legjislatura kombëtare në të gjithë botën.¹ Fushat e bashkëpunimit me parlamentet partnere të HDP-së përfshijnë adresimin e çështjeve buxhetore, sigurimin e punës më efektive të komisioneve, rritjen e shërbimeve mbështetëse, sigurimin e mjeteve për mbikëqyrje më të fortë, forcimin e etikës legjislative dhe përmirësimin e TI-së, bibliotekave dhe kërkimeve, si dhe procesin legjislativ dhe procedurën.² Programet e HDP-së zbatohen nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI) përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi për financim përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC): Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si pjesë e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, është e përkushtuar të sigurojë që shërbimet publike të kryhen me kompetencë në interes të gjithë qytetarëve, që nënkupton adresimin e çështjeve kryesore si decentralizimi, demokratizimi, korrupsioni, burimet natyrore dhe të drejtat e njeriut. Promovimi i demokracisë është një përparësi e politikës së jashtme për Zvicrën. Në partneritet me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, SDC ka nisur Programin e Mbështetjes së Parlamentit (PSP) për të mbështetur qëllimet strategjike të Kuvendit për ligjvënje profesionale dhe efikasë, transparencën parlamentare dhe përfaqësimin efektiv të interesave të qytetarëve. PSP zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve. Ndërhyrjet e PSP-së mbështeten në ekspertizën legjislative zvicerane, estoneze, evropiane, gjermane dhe të tjera, për të avancuar transparencën dhe proceset e efektshme të vendimmarrjes, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe digjitalizimin.

Instituti Nacional Demokratik Kombëtar (NDI): është një organizatë jofitimprurëse, jopartiake, joqeveritare që punon për të mbështetur dhe forcuar institucionet demokratike në të gjithë botën përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, hapjes dhe llogaridhënies së qeverisë. Që nga themelimi i tij më 1983, NDI ka punuar me partnerë lokalë në 156 vende dhe territore, duke bashkuar individë dhe grupe për të shkëmbyer ide, njohuri, përvoja dhe ekspertizë. Partnerët janë gjerësisht të ekspozuar ndaj praktikave më të mira në zhvillimin demokratik ndërkombëtar që mund të përshtaten me nevojat e vendeve të tyre. Qasja shumëkombëshe e NDI-së përforcon mesazhin që thotë se edhe pse nuk ka një model të vetëm demokratik, disa parime thelbësore ndahen nga të gjitha demokracitë. Për këtë qëllim, NDI përqendron bashkëpunimin teknik në zhvillimin e partive politike të qëndrueshme, duke iu dhënë zë grave dhe grupeve të nën përfaqësuar në procesin politik, duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe shoqërisë, duke zhvilluar një qeveri më efektive, të hapur dhe të përgjegjshme në interes të gjithë qytetarëve dhe pjesëmarrësve në procesin politik dhe identifikimin e aplikacioneve të reja teknologjike në procesin demokratik.³

Si të çdo institucioni dhe organizate në mbarë botën, edhe puna e parlamenteve ka qenë penguar nga pandemia globale. Dispozitat për shëndetin publik që synojnë të kufizojnë përhapjen e COVID-19 gjithashtu kanë shkaktuar kaos me mënyrat tradicionale të punës dhe të komunikimit. Parlamenteve, sikurse institucioneve të tjera, iu është dashur të përshtatin me shpejtësi veprimtarinë legjislativë, operacionet dhe rutinat e tyre për të përmbushur prioritetet e vazhdueshme ndaj publikut dhe për të siguruar qeverisjen efektive të vazhdueshme në kohë krize. Për shembull, anëtarët e parlamentit u detyruan të zhvendosnin udhëtimet rutinore midis zyrave të zonave të tyre dhe zyrave në kryeqytet, të përshtaten me nevojat dhe angazhimet me publikun përmes mjeteve virtuale, të promovojnë dhe të fitojnë qasje në të dhëna dhe informacione qeveritare dhe të përmbushin mandatet kushtetuese, duke përfshirë këtu mbikëqyrjen ekzekutive dhe përfaqësimin e qytetarëve. Me rëndësi është që pandemia globale vazhdon të jetë një krizë e madhe shëndetësore, ekonomike dhe sociale që duhet të shërbejë si një thirrje zgjimi për të gjitha parlamentet. Jo vetëm që është e nevojshme të jemi fleksibil në përgjigjen e vazhdueshme ndaj pandemisë, por edhe si pjesë e planifikimit fiskal të paparashikuar para krizave të ardhshme me këto përmasa, qofshin ato një pandemi tjetër, katastrofë natyrore, konflikt ushtarak, krizë ekonomike ose sulm kibernetik.

Partneriteti për demokraci i Dhomës së Përfaqësuesve (HDP dhe Instituti Nacional Demokratik (NDI) kanë bashkëpunuar për të prodhuar këtë udhëzues fiskal të reagimit ndaj situatave emergjente për të ndihmuar parlamentet partnere, të reflektojnë mbi punën e tyre dhe mënyrën se si mund të përshtaten për të siguruar përgjigje efektive përmes politikave dhe qëndrueshmërisë fiskale në kohë të krizave ose sfidave. Ky manual ofron shembuj praktikë dhe një mjet referimi për diskutim mbi aspektet e ndryshme të punës së parlamenteve dhe ofron një seri pyetjesh dhe udhëzimesh për shqyrtimin dhe vetë-reflektimin nga parlamentet dhe udhëheqësit e tyre.

Konsiderimi i aspekteve të tilla të punës së parlamentit lejon një shqyrtim më të matur të asaj se çfarë mësimesh janë marrë gjatë pandemisë dhe se si ato mësimet mund të zbatohen në legjislatura për të informuar planifikimin e tyre për punën e ardhshme. Për këtë qëllim, ky udhëzues parashtron pyetjen: "*Cili është roli më efektiv për parlamentet për të mbështetur politikëbërjen e shëndoshë ekonomike si përgjigje ndaj një krize globale shëndetësore?*" Përveç kësaj, ai adreson pyetjen se si parlamentet mund të përballen me sfidat e qeverisjes që paraqiten nga krizat për të vazhduar kryerjen e funksioneve të tyre legjislativë të politikëbërjes, mbikëqyrjes dhe përfaqësimit në mënyrë efektive.

Disa dokumente kohëve të fundit kanë trajtuar këto çështje, veçanërisht për sa i përket mënyrës se si legjislaturat mund të përshtatin procedurat, praktikat dhe marrëdhëniet e tyre legjislativë-ekzekutive.⁴ Ky punim përqendrohet më specifikisht në masat që qeveritë - ekzekutivi dhe parlamenti së bashku - kanë ndërmarrë për të adresuar ndikimet e pandemisë COVID-19 mbi individët dhe bizneset. Ai gjithashtu synon të sigurojë udhëzime për parlamentarët, stafin parlamentar dhe praktikuesit në fushën e zhvillimit legjislativ dhe qeverisjes së mirë për atë që parlamentet mund të bëjnë për të zbatuar politikën e lehtësimit dhe rimëkëmbjes emergjente dhe ekonomike, në kohëra të krizave, me një fokus në zbatimin e barabartë dhe përgjegjës të politikave dhe të resurseve.

Roli i parlamenteve gjatë krizës
Sigurojnë stabilitet dhe kontinuitet
Promovojnë transparencë dhe diversitet
Garantojnë ekuilibrin e forcave
Përfaqësojnë zërin e qytetarëve
Japin legjitimitet vendimeve qeveritare
Kërkojnë llogaridhënie nga qeveritë

Ky dokument ofron informacione të përgjithshme në lidhje me ndikimin ekonomik të pandemisë KOVID-19, diskuton rolin e parlamenteve në situata krize dhe rishikon përgjigjet e politikave ekonomike me shembuj të masave të ndihmës nga e gjithë bota, veçanërisht duke theksuar ato që synojnë grupe të cënueshme siç janë punëtorët joformalë dhe gratë. Diskutohen edhe temat e llogaridhënies dhe vendimmarrjes së informuar, duke theksuar konsiderata kritike për rolin e parlamentit në mbikëqyrjen e buxhetit dhe zbatimin e përgjegjshëm të tij.

Duke u bazuar në përvojën globale dhe ndërhyrjet vijuese parlamentare gjatë pandemisë aktuale, një konsensus në zhvillim mbi mënyrën se si legjislaturat mund të ndërtojnë përgjigje efektive të politikave gjatë një krize, veçanërisht një që prish aktivitetin ekonomik, përfshin bazat dhe praktikën e mira të mëposhtme:

- Qeveritë duhet të ofrojnë resurse emergjente të menjëhershme dhe të konsiderueshme dhe fonde të ndihmës, dhe/ose të sigurojnë lehtësime tatimore për të mbështetur individët, familjet dhe bizneset dhe për të stimuluar kërkesën;



Uashington, DC, 10 mars 2021). Nga e majta, kongresmenia Maxine Waters, D-Calif., Kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi, D-Calif., Udhëheqësi i shumicës së Senatit Chuck Schumer, D.n.y., kongresmenia Carolyn Maloney, D.n.y., Jim McGovern, D-Mas., dhe Katherine Clark, D-Mass., marrin pjesë në një ceremoni të regjistrimit të ligjit për Aktin e Planit të Shpëtimit Amerikan në pjesën e përparme nga pamja perëndimore e Kapitolit pasi që Dhoma e përfaqësuesve kaloi paketën e ndihmës kundër KOVID-19 prej \$1.9 trilionë. Burimi: Tom Williams / Gettyimages.com

- Burimet publike duhet të orientohen në vendet e duhura, që përfshijnë individë dhe familje që kanë më shumë nevojë për të, dhe sektorë të ekonomisë dhe bizneseve që kanë më shumë nevojë;
- Nevojiten të dhëna të besueshme, gjithëpërfshirëse për të arritur një dorëzim efektiv të ndihmës, krahas një infrastrukture të fortë dhe ndërvepruese që mbështet kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë para dhe burime të tjera; dhe
- Qeveritë dhe parlamentet duhet të shfrytëzojnë rastin për të përgatitur masa për zgjidhjen krizave të ardhshme, të tilla si ngjarje të papritura, katastrofa të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, pandemi ose konflikte të ardhshme, që do të mund t'i tejkalojnë pabarazitë e afatgjata në shoqëri.

Elementet kryesore se si parlamenti mund të kontribuojë më së miri ndaj kësaj "formule" për politikëbërje të mirë mund të përmbledhet si më poshtë:

- Të bëhet ekuilibri i duhur në dhënien e kompetencave emergjente që i duhen ekzekutivit për të zgjidhur krizën në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt, duke ruajtur normat demokratike në lidhje me përgjegjësinë, mbikëqyrjen dhe përfshirjen;
- Zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të parlamenteve, veçanërisht në sferën e infrastrukturës digjitale dhe mbledhjes së të dhënave, që do të mundësojnë vazhdimësinë e punës parlamentare dhe kapacitetin analitik buxhetor dhe fiskal;
- Puna në vazhdimësi për të siguruar që infrastruktura ligjore, administrative dhe teknike është në një nivel për të siguruar ndihmë financiare dhe lehtësim për njerëzit dhe bizneset, veçanërisht në zonat e goditura rëndë;
- Sigurohuni që politikën e miratuar në situata krize marrin parasysh nevojat unike ose disproporcionale të grupeve veçanërisht të rrezikuara dhe të marginalizuara historikisht, të tilla si gratë dhe punëtorët joformalë, dhe se politikën gjithashtu marrin parasysh çështjet e qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor; dhe
- Dizajnimi, miratimi dhe monitorimi i programeve të situatës emergjente për t'u siguruar që ato synojnë ata që janë më të ndikuar dhe minimizojnë shpenzimet e panevojshme dhe korrupsionin.

Historiku

Që kur Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) deklaroi shpërthimin e koronavirusit si një emergjencë e shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar në janar të vitit 2020, vendet në të gjithë botën kanë ndërmarrë masa të jashtëzakonshme si përgjigje ndaj pandemisë për të lehtësuar rreziqet e saj shëndetësore dhe ndikimin negativ ekonomik. Duke pasur parasysh efektin e virusit në shëndetin dhe mirëqenien publike, shumë qeveri iu drejtuan ligjeve dhe masave emergjente për të frenuar sa më shpejt përhapjen e virusit, deri sa përipiqeshin të siguronin ndihmë ekonomike për familjet dhe bizneset. Shumë vende kanë vepruar me guxim për të kufizuar vështirësitë dhe pengesat ekonomike të shkaktuara nga virusi, duke zbatuar një numër masash, të tilla si subvencionet e pagave, përfitimet e pushimeve mjekësore ose shtyrjet e taksave. Pandemia KOVID-19 gjithashtu ndikoi shpejt dhe rëndë në ekonominë globale, me shumë tregje që vazhdojnë të përjetojnë paqëndrueshmëri. Për më tepër, shumë vende që tashmë përballen me presione të rënda financiare, veçanërisht të lidhura me nivelet e borxhit në kohën e goditjes nga pandemia, tani po luftojnë me efektin e shtuar të vazhdueshëm të krizës me hapësirë të kufizuar për të marrë vendime në lidhje me shpërndarjen e burimeve.



(Kigali, Ruanda, 22 qershor 2020) Uzziel Ndagijimana, Ministër i Financave dhe Planifikimit Ekonomik i Ruandës, paraqet buxhetin për vitin fiskal 2020/21 përpara parlamentit në Kigali, kryeqyteti i Ruandës.

Burimi: Cyril Ndegeya / Xinhua / Gettyimages.com

Përveç rritjes të dallimeve, kriza KOVID-19 ka nxjerrë në pah më tej pabarazinë dhe vështirësitë e resurseve midis grupeve tashmë të marginalizuara dhe të cenueshme, veçanërisht gratë dhe ato që shërbejnë në vijat e para dhe në ekonominë joformale. Shumë prej këtyre punëtorëve janë anëtarë të grupeve të marginalizuara si personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe anëtarët e komunitetit LGBTIQI +.

Duke marrë parasysh potencialin për paraqitjen e krizave të papritura në të ardhmen, bëhet gjithnjë e më urgjente nevoja që vendet të praktikojnë vendime efektive dhe të vendosin masa për rezistencë në marrjen e vendimeve për politikën gjatë kohës së krizës. Gjithashtu, shumë shtete edhe më tej janë të ngarkuara edhe me kriza të tjera paralele, përfshirë degradimin e mjedisit jetësor, katastrofat klimatike, dhe/ose dhuna politike, etnike ose sektare. Pandemia dhe emergjencat e tjera të mundshme në të ardhmen, së bashku me krizat e tjera kërkojnë një përgjigje të koordinuar dhe përshtatje të politikës strategjike

Përhapja e KOVID-19 ka transformuar thellësisht mënyrën se si njerëzit dhe organizatat kryejnë punën e tyre të përditshme. Parlamentet në të gjithë globin nuk janë kursyer nga efektet negative të virusit. Në veçanti, legjislativave u është lënë hapësirë më e kufizuar për veprim për të kryer funksionet e tyre tradicionale të ligjvënies, mbikëqyrjes dhe përfaqësimit. Parlamentet gjithashtu përballen me sfida të pashembullta më parë në kapacitetet e tyre operacionale për shkak të masave shëndetësore që kufizojnë tubimet dhe lëvizjen.⁵ Pandemia gjithashtu ka përkeqësuar hendeqet në aftësinë e legjislativave për të kryer mbikëqyrje efektive të vendimeve të qeverisë që ndikojnë në cilësinë e masave të miratuara. Sidoqoftë, ka edhe shembuj të përgjigjeve inovative parlamentare, posaçërisht mbi politikën efektive të reagimit ndaj situatave emergjente.

Duke njohur rëndësinë e ndarjes së informacionit mes kolegëve, pjesa kryesore e këtij dokumenti përfshin shembuj të risive dhe sukseseve në politikëbërje që nga fillimi i pandemisë, me kuptimin që parlamentet përballen me sfida unike në varësi të kapacitetit të tyre individual, institucional dhe konteksteve politike dhe ekonomike. Edhe pse qëllimi i këtij studimi është të nënvizojë përgjigjet efektive fiskale dhe ekonomike ndaj krizës shëndetësore, ai gjithashtu synon të sigurojë udhëzime praktike për parlamentarët që veprojnë në krizat e mundshme të ardhshme, për shembull, ndikimet klimatike, katastrofat natyrore, krizat ekonomike dhe konfliktet. Rekomandimet kryesore për parlamentet përfshihen në brendinë e këtij dokumenti. Për më tepër, mësimet e nxjerra dhe pikat e mundshme të veprimit për parlamentarët janë dhënë në Aneksin 1.

Qëllimet e punimit kërkimor

Ky dokument ofron dëshmi të mënyrave në të cilat parlamentet u janë përgjigjur nevojave të qytetarëve gjatë pandemisë. Ai gjithashtu ofron shembuj praktikë me pyetjet kryesore të sugjeruara për t'u marrë në konsideratë për të ndihmuar anëtarët e parlamentit (deputetët) dhe stafin e tyre të vlerësojnë, analizojnë dhe propozojnë politika kuptimplota, të cilat promovojnë rimëkëmbjen dhe zhvillimin ekonomik gjatë periudhave të krizës fiskale, siç është KOVID-19.

Duke pasur parasysh funksionet legjislative, përfaqësuese dhe mbikëqyrëse, ky udhëzues prezanton mësimet e marra dhe teknikat e aplikuara që nga shpallja e pandemisë globale. Ai gjithashtu identifikon udhëzimet kryesore për paraqitjen e ndryshimeve në legjislacion dhe procedurat parlamentare që inkurajojnë një menaxhim më efektiv fiskal. Punimi gjithashtu përfshin një numër të zgjedhur studimesh të shkurtra të rasteve me shembuj të praktikave të mira të përdorura nga legjislaturat gjatë pandemisë. Çdo seksion gjithashtu përfshin një sërë udhëzimesh, bazuar në përvojat e legjislatrave globale që adresojnë përgjigjet fiskale në një skenar krize. Për më tepër, secili seksion përfshin një sërë pyetjesh për diskutim midis aktorëve kryesorë në një parlament.

II. PËRCAKTIMI I POLITIKAVE FISKALE DHE MONETARE DHE MASAT E RIMËKËMBJES EKONOMIKE NGA PANDEMIA

Kur ekspozoheni në një situatë emergjente, siç është një pandemi ose një katastrofë natyrore, një parlament i qëndrueshëm është në gjendje t'i rezistojë dhe t'i përshtatet rrethanave të reja dhe sfiduese në një mënyrë efikase dhe në kohë, duke ruajtur dhe kthyer funksionet thelbësore të tij (ligjvënia, mbikëqyrja dhe përfaqësimi) dhe strukturat (plenaryja dhe komisionet). Kjo veçanërisht përfshin mbikëqyrjen e shpenzimeve kombëtare, si fondet e emergjencës ose resurset e alokuara për adresimin dhe menaxhimin e krizave. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që parlamentet, të cilat përballen me reagimin ndaj krizës të marrin në konsideratë politikën fiskale, politikën monetare dhe masa të tjera që kanë për qëllim të ruajnë stabilitetin ekonomik, duke siguruar që burimet të alokohen me përgjegjësi, në mënyrë të sigurt dhe të barabartë dhe të administrohen në komunitetet në të cilat ka nevojë. Kjo është sepse aftësia e një vendi për të reaguar në kohëra të krizës shpesh përcaktohet nga gjendja e tij ekonomike në hyrje të krizës dhe nga shkalla në të cilën vetë politikat fiskale dhe monetare mund të përballojnë goditjet e mundshme.⁶

Për shembull, gjendja e emergjencës ose masat e emergjencës janë vegla kritike në kohëra krize pasi që deklarimi i një gjendjeje emergjente shpesh ngrit kompetenca të jashtëzakonshme nga pushteti ekzekutiv për të trajtuar emergjencën. Si përgjigje ndaj pandemisë KOVID-19, pothuaj se 100 vende në mbarë botën shpallën gjendje të jashtëzakonshme⁷ dhe në shumicën e rasteve, qeveritë vendosën një varg masash kufizuese, të tilla si orët policore, karantina të detyrueshme ose mbyllje të bizneseve jo-thelbësore. Megjithatë veprimet e tilla mund të jenë justifikuar për të parandaluar transmetimin e KOVID-19, ato gjithashtu u përdorën nga qeveritë për të abuzuar ose tejkaluar kompetencat e tyre të mandatuara me kushtetutë. Në raste të tjera në botë, parlamentet u deleguan qeverive pushtet për të marrë vendime të rëndësishme përmes dekreteve presidenciale ose ministrore. Praktikrat e shqyrtimit dhe mbikëqyrjes parlamentare kanë pasur rënie të konsiderueshme që nga fillimi i pandemisë, duke pasur parasysh se shumë ligje emergjente u miratuan përmes procedurave të shpejta legislative. Kjo, e kombinuar me procedurat parlamentare të cilat shpesh ishin të kufizuara për shkak të masave të distancës sociale, rezultoi në mbikëqyrje të paktë parlamentare mbi masat e reagimit ndaj pandemisë. Në përgjithësi, parlamentet duhet të ushtrojnë funksionin e tyre të mbikëqyrjes edhe gjatë periudhave të krizës dhe të mos heqin dorë nga roli jetik që luajnë në mbikëqyrjen e politikave të tilla të rëndësishme.

Në shumë raste, vendet u përgjigjën duke adresuar ndikimet ekonomike të pandemisë në komunitetet në nevojë. Për shembull, disa u përgjigjën përmes **politikave fiskale** (politikat që lidhen me shpenzimet dhe taksat) dhe **politikat monetare** (politikat që lidhen me sasinë e parave). Politikat e tilla kishin për qëllim të siguronin që individët dhe bizneset të kishin qasje në burime dhe fonde të mjaftueshme për të mirëmbajtur operacionet standarde minimale dhe fondet për të mbuluar nevojat themelore. Ato gjithashtu ndihmuan në sigurimin e sasisë së mjaftueshme të kapitalit dhe të parave të gatshme për të mbrojtur ekonomitë nga ndikimet e mëtejshme si rezultat i krizës shëndetësore. Roli i legjislaturës në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e masave të tilla dallonte nga vendi në vend. Sidoqoftë, ka shumë mësim për të nxjerrë nga kjo përvojë dhe se si parlamentet mund të jenë aktive në përmeshjen e funksioneve të tyre, edhe gjatë një situatë emergjente.

Politika fiskale

Politika fiskale ka të bëjë me vendimet e miratuara nga parlamentet dhe pushteti ekzekutiv në lidhje me shpenzimet, mbledhjen e taksave (përfshirë uljen ose shtyrjen e taksave gjatë rrethanave sfiduese siç është një pandemi) dhe ndikimet e politikave në aktivitetin ekonomik. Politikat fiskale të zhvilluara dhe të zbatuara nga qeveri të ndryshme gjatë pandemisë kanë luajtur një rol vendimtar në zbutjen e efekteve negative ekonomike dhe sociale.

Për shembull, siç do të vëreni në këtë udhëzues, shumë vende kanë zbatuar masa të likuiditetit (rritja e sasisë së parave) së bashku me politikat e lehtësimit fiskal, për të kufizuar dëmin dhe vështirësitë ekonomike. Kjo përfshin sigurimin e fondeve të drejtpërdrejta për bizneset dhe pagesa financiare për familjet dhe individët për t'i ndihmuar ata gjatë krizës. Për më tepër, bashkëpunimi shumëpalësh është thelbësor për të kthyer rritjen ekonomike globale.

Për shembull, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vazhdon të angazhohet me të gjitha vendet anëtare për të inkurajuar mobilizimin e të ardhurave dhe për të stimuluar fitimet ekonomike. Përveç kësaj, shumë vende (përfshirë këtu edhe Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende

Është me rëndësi që parlamentet të cilat ballafaqohen me një përgjigje ndaj krizës të marrin në konsideratë politikën fiskale, politikën monetare dhe masa të tjera që synojnë të ruajnë stabilitetin ekonomik, duke siguruar që burimet të ndahen me përgjegjësi, në mënyrë të sigurt dhe të barabartë dhe të administrohen dhe t'u ndahen komuniteteve të cilat kanë nevojë

Evropiane) krijuan fonde KOVID-19 jashtë buxhetit për të ndihmuar në mobilizimin e burimeve dhe përshejtimin e shpenzimeve emergjente diku tjetër.⁸ Gjithashtu, përpjekjet si Plani i Veprimit G20 për të menaxhuar KOVID-19 kanë punuar për të mundësuar veprime të përbashkëta midis aktorëve në mbarë ekonominë globale.⁹

Përmes politikës fiskale, parlamentet kanë hapësirë për të ndikuar në përgjigjet e qeverisë të cilat adresojnë ndikimin ekonomik nga krizat. Në mënyrë të veçantë, politikat fiskale mundësojnë që parlamenti të mbrojë dhe të miratojë shpërndarjen e burimeve, duke u bazuar në nevojat dhe prioritetet e qytetarëve, të sigurojë një bazë të fortë taksash për të ruajtur shërbimet publike me këste të qëndrueshme të huamarrjes dhe të sigurojë prova duke u bazuar në rolin e shpenzimeve dhe lehtësimin e taksave që kanë mbi ri zhvillimin dhe ecurinë e ekonomisë.

Parlamentet gjithashtu mund të përdorin politikën fiskale, përmes shpenzimeve qeveritare dhe politikave tatimore, për të ndikuar në rritjen e një ekonomie pas një krize. Të menduarit për normat e parashikuara të rritjes vjetore deri sa ekonomia rikuperohet nga goditja e krizës, e kombinuar me të dhëna të besueshme të gjeneruara nga mekanizmat e shqyrtimit dhe mbikëqyrjes parlamentare (të tilla si zyrat e auditimit, të cilat do të diskutohen në pjesën në vijim), lejon parlamentin që të parashikojë, planifikojë dhe më pas të adresojë në mënyrë efektive sfidat e balancimit të një kthimi të vitalitetit ekonomik pas një krize. Me fjalë të tjera, parlamenti mund të punojë me ekzekutivin për të hartuar **politikë fiskale ekspansioniste**, e cila më vonë mund të rishikohet përmes uljes së masës monetare dhe/ose rritjes së taksave për të promovuar **politikën fiskale tkurrëse**.

Vini re se derisa disa masa të ndërmarra gjatë pandemisë KOVID-19 kanë për qëllim të sigurojnë lehtësim më të menjëhershëm për bizneset, familjet, komunitetet e marginalizuara dhe individët, të tjerat kanë për qëllim të rrisin aktivitetin ekonomik në përgjithësi. Ndërrhyrjet e tilla mund të kenë filluar si një përgjigje e menjëhershme ndaj emergjencës, por do të ketë një nevojë afatmesme që veprimet e tilla të vazhdojnë dhe, ndoshta, të modifikohen. Përkundër faktit që shumica e vendeve parashikohet të përjetojnë deficite fiskale më të ulëta në vitin 2021 (në krahasim me vitin 2020) me rritjen e të ardhurave, shpenzimet do të bien automatikisht kur të skadojnë masat e përkohshme të lidhura me pandeminë. Sidoqoftë, pa mbështetje plotësuese fiskale përtej asaj që është përfshirë në planet buxhetore të 2021, tkurrjet fiskale të parashikuara këtë vit mund të ngadalësojnë rimëkëmbjen, ecuria dhe shtrirja e së cilës mbeten të pasigurta.¹⁰

Në përgjithësi, parlamenti mund të marrë masa të caktuara për të kundërshtuar ndikimin negativ fiskal nga pandemia në ekonomi, duke përfshirë:

- Shtyrjen e pagesave të taksave (për individë dhe biznese)¹¹
- Subvencione për sektorin publik¹²
- Lehtësime tatimore dhe ndihma financiare (për individë dhe biznese)¹³
- Mbështetje për të ardhurat/pagesa të parave të gatshme ("çeqe stimuluese")¹⁴
- Skema për punësime afatshkurtra¹⁵
- Pushim mjekësor i paguar¹⁶
- Benefite të zgjeruara dhe më të disponueshme për të papunësuat¹⁷
- Lehtësim nga hipotekat dhe pagesat e qirasë¹⁸
- Shpenzime të infrastrukturës¹⁹

Për çdo politikë të paraqitur më lart, deputetët duhet të bëjnë zgjedhje mbi madhësinë e programit dhe jetëgjatësinë e tij, cilët janë përfituesit e synuar, administrimin dhe shpërndarjen dhe vlerësimin e efektivitetit. Në disa raste, dispozitat e politikave që lejojnë pagesa të drejtpërdrejta për grupe ose industri të specializuara mund të zgjerohen, veçanërisht ato që kanë për qëllim grupe të marginalizuara dhe të cenueshme, si gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët joformalë dhe kujdestarët. Konsideratat e tjera përfshijnë shtesat në pagesa për sektorët e goditur më rëndë gjatë një krize (në rastin e KOVID-19, shembujt përfshijnë turizmin, industrinë e ushqimit dhe të restoranteve, argëtimin dhe kompanitë ajrore).²⁰ Parlamentet luajnë një rol kyç në sigurimin që pagesat dhe shërbimet e tilla adresojnë prioritetet e qytetarëve të cilat janë theksuar nga përfaqësuesit dhe votuesit.

Shembull:


Parlamenti i Norvegjisë ka miratuar një projekt-ligj që do t'i mundësonte qeverisë futjen e masave urgjente për të zbutur ndikimet negative fiskale të pandemisë. Propozimi i qeverisë përfshin një klauzolë që do të lejonte parlamentin në çdo kohë të dhënë të shfuqizojë plotësisht ose pjesërisht aktin mundësues me një të tretën e votave në Dhomë.²¹

Pyetjet kryesore për t'u marrë parasysh:



- Cila është kompetenca ligjore dhe kushtetuese e parlamentit në krijimin e ligjeve gjatë një situatë emergjente?
- Si mund të sigurohet që parlamenti të ruajë kompetencën e vet ligjvënëse, duke mundësuar përshpejtimin e legjislativionit të ri të nevojshëm për të zgjidhur një situatë emergjente të tillë si pandemia?
- Çfarë resurse dhe infrastrukturë i duhen parlamentit për t'i mundësuar që ai të jetë rezistent, i përgjegjshëm dhe efektiv gjatë një situatë emergjente?
- Çfarë të dhënash ekzistojnë ose janë duke u mbledhur për të matur performancën ekonomike në një kohë krize, dhe çfarë tregojnë ato të dhëna për atë se kush ndikohet më drejtpërdrejt nga një emergjencë? Si u jepet vëmendje kryesore atyre më të rrezikuara dhe më pak të përfaqësuarve në shoqëri duke u bazuar në të dhënat e disponueshme socio-ekonomike?
- Cilat ligje dhe politika ekzistojnë për të mundësuar një përgjigje të shpejtë fiskale ndaj një emergjence?
- Cilat segmente të popullsisë ishin ose janë bërë të cenueshme për shkak të urgjencës për të cilën kërkohen ndërhyrje konkrete?

Udhëzime:



- Mendoni për përfshirjen e kërkesave të detyrueshme dhe rutinore të raportimit mbi politikat e lehtësimeve fiskale në situatë emergjente në legjislativion, për autorizime me të cilat mundësohet lejimi i shpenzimeve lidhur me këto politika.
- Rishikoni Rregulloren në mënyrë që të mund të përshtatet sipas nevojës në një krizë që të parashihet puna në distancë ose votimit përmes personave të autorizuar si shembull.
- Kur propozim-ligji kërkon miratim të shpejtë për shkak të një emergjence, kjo nuk duhet të përjashtojë mundësinë që deputetët dhe bllloqet parlamentare të marrin propozim-ligjin me kohë të mjaftueshme për të lejuar një kontroll thelbësor.
- Mendoni për vendosjen e "klauzolës për kufizim kohor të vlefshmërisë" (e njohur edhe si një stabilizues automatik) në buxhetin e emergjencës dhe masat e politikës ekonomike, të cilat bazohen në tregues ekonomikë siç janë nivelet e rritura të punësimit, ulja e kërkesave mujore nga të papunësuarit dhe/ose shpenzimet e konsumatorit që mund të certifikohen në mënyrë të pavarur, kështu duke shmangur ndërhyrjet politike/qeveritare mbi të dhënat aktuale ekonomike.²²
- Përqendrohuni në monitorimin, përshtatjen dhe koordinimin e masave të rimëkëmbjes për situatën fiskale në zhvillim. Ky fokus mund të zhvendoset nga lehtësimi gradual i masave stimuluese ekonomike, duke promovuar rihapjen e bizneseve përtej atyre që konsiderohen thelbësore.

Politika monetare

Politika monetare i referohet sasisë së parave në ekonomi dhe masave që qeveritë mund t'i ndërmarrin për të rritur atë sasi ("likuiditet") për të siguruar fonde plotësuese për blerje dhe investime. Qëllimi i politikave të tilla është rritja e fluksit të parave dhe mallrave/shërbimeve, duke stimuluar aktivitetin ekonomik.

Pandemia KOVID-19 vazhdon të ketë ndikime të konsiderueshme negative mbi sasinë e parave në tregjet financiare ndërkombëtare, gjë që mund ta bëjë më sfiduese kthimin në rrjedhën e zakonshme të biznesit në muajt dhe vitet e ardhshme. Që nga fillimi i pandemisë, qeveritë kanë ndërmarrë masa specifike për të zbutur këtë efekt. Për shembull, në mars të vitit 2020, **Shtetet e Bashkuara** ndërhyjnë përmes Komisionit Federal të Tregut të Hapur (FOMC), i cili iu përgjigj ndikimit ekonomik të krizës shëndetësore, duke ulur normën e interesit të synuar për institucionet financiare për të marrë hua në gati në zero, duke përfshirë huazimin emergjent dhe blerjet e pasurive.²³

Qeveritë në **Liban**, **Jordani** dhe **Katar** siguruan hua përmes bankave tregtare për kompanitë për të paguar pagat me interes të ulët ose zero.²⁴ **Peruja** rriti shumën maksimale të huas për kompanitë bazuar në madhësinë e biznesit deri në 50 për qind.²⁵ Bankat qendrore të **Brazilit**, **Kilit** dhe **Kolumbisë** blenë letra me vlerë si private ashtu edhe qeveritare në tregjet e brendshme financiare dhe rregulloret për kredimarrje u lehtësuan për t'i lejuar bankat tregtare të ri negociojnë huat me familjet dhe firmat, pa ndikuar në vlerësimet e tyre të kreditit.²⁶ Meqenëse këto masa kanë një efekt të menjëhershëm dhe afatshkurtër, është e rëndësishme të theksohet se rregullimi i mëtejshëm i politikave monetare, për të ruajtur stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e tij, mund të jetë i nevojshëm në planin afatgjatë.²⁷

Një politikë e tillë që është përdorur gjatë pandemisë është **lehtësimi sasior**, një formë e politikës monetare jokonvencionale në të cilën një bankë qendrore blen letra me vlerë më afatgjatë nga tregu i hapur në mënyrë që të rrisë furnizimin e parave dhe të inkurajojë huadhënien dhe investimet. Blerja e këtyre letrave me vlerë shton para të reja në ekonomi dhe gjithashtu shërben për të ulur normat e interesit duke ofruar letra me vlerë me të ardhura fikse.

Ajo gjithashtu zgjeron bilancin e bankës qendrore. Siç u përmend më lart, kur normat afatshkurtra të interesit janë zero ose në afërsi të zeros, operacionet normale të tregut të hapur të një banke qendrore gjatë periudhës para-pandemike që synojnë normat e interesit nuk janë më efektive. Në vend të kësaj, një bankë qendrore mund të synojë shuma të caktuara të asetëve për të blerë. Lehtësimi sasior rrit furnizimin e parave duke blerë asete me rezerva bankare të sapo krijuara në mënyrë që t'u ofrojë bankave më shumë likuiditet që lejon huamarrësit (si bizneset ashtu edhe konsumatorët) të kenë më shumë para për të shpenzuar dhe në këtë mënyrë të stimulojnë aktivitetin ekonomik.²⁸ Gjatë pandemisë, disa vende përdorën lehtësimin sasior si një metodë për të inkurajuar aktivitetin ekonomik. Për shembull, Banka e Indonezisë, banka qendrore e vendit, ka derdhur afër 25 miliardë dollarë likuiditet plotësues në tregun lokal që nga janari i vitit 2020 për të mbështetur ekonominë më të madhe në Azinë Juglindore. Sidoqoftë, lehtësimi sasior kërkon një plan stimulus fiskal në mënyrë që të maksimizohet ndikimi pozitiv i një fondi të tillë qeveritar në rimëkëmbjen ekonomike gjatë një krize. Në Indonezi, kjo përfshin shpenzimet për kujdesin shëndetësor, rrjetin e sigurimeve shoqërore për ata më të rrezikuar dhe për bizneset e vogla dhe të mesme.²⁹


Shembujt e mëposhtëm janë ato që parlamentet ndërmorën gjatë pandemisë për t'u përballur me ndikimet monetare gjatë pandemisë dhe për të theksuar rolin e parlamentit në adresimin e politikave monetare të qeverisë që kërkojnë masa të ndërthurura të kontrollit. Për shembull, parlamenti i **Timor Leste** njëzëri miratoi një rezolutë që përmban masa urgjente për t'u përgjigjur KOVID-19, posaçërisht të drejtat e qytetarëve, furnizimin e mallrave dhe rregullimin e shërbimeve thelbësore. Përveç sigurimit të lehtësimit të përgjithshëm gjatë pandemisë, qëllimi kryesor i rezolutës ishte të lehtësonte barrën e furnizimit të parave në vend, derisa ende lejonte bizneset dhe punëtorët të kishin akses në kredi dhe me këtë në burimet pas pandemisë. Rezoluta përshkroi gjithashtu masat për të siguruar punën e vazhdueshme të industrisë ushqimore, shërbimet mjekësore, shpërndarjen e karburanteve dhe qarkullimin ndërkombëtar të mallrave. Paketa e ndërhyrjes emergjente përfshinte gjithashtu dispozita për të siguruar vazhdimin e drejtësisë, punësimit dhe mbrojtjes sociale për kompanitë, të tilla si bizneset e vogla dhe shitësit rrugorë.³⁰ Gjithashtu, në **Shqipëri**, ndërhyrjet e politikës u prezantuan për të ulur pengesat e likuiditetit për kompanitë dhe individët përmes Bankës së Shqipërisë, e cila siguroi një pezullim të përkohshëm të kërkesave për klasifikimin e kredisë dhe provizioneve, për të lejuar klientët të shtyjnë këstet e huas pa gjobë. Ristrukturimi i huamarrjes dhe mbrojtjet e kredisë gjithashtu u miratuan si dhe kufizimet e huamarrjes jashtë gjykatës për huamarrësit në gjendje të vështirë u zgjatën deri në vitin 2022. Ulja e normës të huazimit si politikë kryesore në 0.5 për qind gjithashtu kishte për qëllim rritjen e likuiditetit në ofertën monetare, derisa u mundësoi bizneseve dhe konsumatorëve të rikuperohen nga tronditja ekonomike e pandemisë.³¹ Në **Maldivë**, ministri i Financave kërkoi një pezullim të pjesëve të Aktit për Përgjegjësi Fiskale³² dhe parlamenti iu përgjigj shpejt kërkesës duke krijuar një ad hoc komision për të shqyrtuar heqjen e kufijve të borxhit të vendosura nga ky akt. Komisioni u takua për një periudhë prej vetëm disa ditësh, por ishte në gjendje të siguronte kontribute në kohë dhe mundësoi një vendim të informuar nga parlamenti në lidhje me kërkesën e ministrit.³³

Pyetjet kryesore për t'u marrë parasysh:



- Si do të hartohen masat për situatë emergjente lidhur me ndryshimet e politikës monetare? Si mundet që programi(et) të minimizojnë burokracinë, gjithnjë duke mbajtur kontrollin, me qëllim që të shmangen shpenzimet e panevojshme?
- Si mund të sigurojnë deputetët kontribute thelbësorë në hartimin e programeve të tilla gjatë një situatë emergjente?
- Në çfarë informacione dhe të dhënash duhet të kenë qasje deputetët, që të angazhohen në mënyrë aktive në një debat domethënës mbi politikën monetare emergjente?
- Cilat sisteme duhet të ekzistojnë për të lejuar angazhim rutinor të deputetëve dhe të parlamentit gjatë një emergjence?

Udhëzime:



- Zhvilloni programe që janë të orientuara drejt atyre që kanë më shumë nevojë për lehtësimin e shlyerjes së huamarrjes. Një punë e tillë do të kërkojë qasje në të dhënat kryesore dhe konsultime me grupet e cenuara për të kërkuar reagime dhe kontribut në hartimin e programeve të tilla. Gjithashtu do të kërkojë përpjekje të orientuara për t'i bërë ata që janë më të prekur, më të vetëdijshëm për mundësinë për t'iu qasur programeve të tilla.
- Mendoni nëse programet që kanë të bëjnë me furnizimin me para duhet të zbatohen drejtpërdrejt nga qeveria ose përmes partnerëve të sektorit privat, siç janë bankat.

Masa të tjera

Shumë vende kanë qenë në gjendje të zbusin të paktën disa nga ndikimet negative ekonomike brenda kufijve të tyre me paketa të forta stimuluese që kombinojnë disa ose edhe të gjitha masat e përmendura më lart. Sidoqoftë, ka mekanizma të tjerë, siç janë politikat tatimore, që vendet mund të përdorin për të lehtësuar barrën e ndikimeve ekonomike gjatë një krize. Për shembull, vendet mund të miratojnë masa që lejojnë **shtyrjen e pagesave të taksave**, të cilat u lejojnë individëve, familjeve dhe bizneseve kohë shtesë, si rezultat presion të ulur dhe lehtësim të shtuar, për pagesat e nevojshme të taksave.³⁴ Disa vende gjithashtu kanë miratuar **skema të punës afatshkurtër**,³⁵ që përfshijnë qeveritë të paguajnë mbështetje për të ardhurat e punëtorëve orët e punës së të cilëve janë zvogëluar ose për ata që janë pushuar përkohësisht, me kusht që punëdhënësi do të mbajë punëtorët e tillë. Ky model supozon se punëtorët do të vazhdojnë të punojnë me kohë të plotë kur kushtet ekonomike të përmirësohen dhe kur të ketë kaluar kriza shëndetësore - ose të paktën të bëhet e menaxhueshme, falë vaksinimit të përhapur dhe imunitetit të përgjithshëm që do rezultojë.³⁶

Programi kundër-ciklik për zgjerimin e zhvillimit të Mongolisë

Si një vend me të ardhura mesatare më të ulëta, ekonomia e Mongolisë varet shumë nga nxjerrja e burimeve natyrore. Gjatë pandemisë, nxjerrja e mineraleve u ndërpre, dhe qeveria dhe parlamenti lëvizën shpejt që në mars të vitit 2020 të përgjigjen me programin kundër-ciklik për të kompensuar një humbje të të ardhurave për qytetarët dhe bizneset. Programi kundër-ciklik për zgjerim të zhvillimit (CDEP) u mbështet nga një hua prej 100 milionë dollarë nga Banka e Zhvillimit të Azisë për të mbështetur përpjekjet e saj. CDEP financoi një numër iniciativash, të tilla si transferime të drejtpërdrejta të parave të gatshme për qytetarët, një zgjerim të Programit kombëtar të Parave për Fëmijët me 50 për qind dhe një përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale për ata që punojnë në sektorin privat. Për më tepër, bizneset nuk u ngarkuan me pagimin e taksave të sigurimeve shoqërore për gjashtë muaj në vitin 2020. Parlamenti luajti rol në miratimin e programit dhe në detyrimin e autorizimit të masave specifike të emergjencës në baza mujore, ashtu siç zhvillohej situata emergjente.

Burimi: <https://www.adb.org/sites/default/files/project-documents/54174/54174-001-rrp-en.pdf>

Për më tepër, disa vende kanë rritur mbështetjen për familjet dhe individët si për shembull nëpërmjet zgjerimit ose rritjes së **benefiteve për të papunësuarit** për punëtorët me gjysmë orari të punës dhe për të vetë-punësuarit dhe kanë zgjatur pushimin mjekësor dhe benefitet familjare. Gjithashtu, si në vendet me të ardhura të larta, ashtu edhe në ato me të ardhura të ulëta, **transferimet e parave të gatshme** familjeve dhe



(Bogota, Kolumbi, 12 gusht 2020). Senator kolumbian dhe ish-kandidati presidencial Gustavo Petro dezinfekton duart e tij si masë parandaluese kundër përhapjes së koronavirusit të ri, gjatë një debati parlamentar në distancë në Kongresin Kombëtar në Bogota.

Burimi: Juan Barreto / Gettyimages.com

individëve kanë qenë një vegël e rëndësishme në përgjigjet ndaj KOVID-19, si për të lehtësuar vështirësitë, ashtu edhe për të nxitur aktivitetin ekonomik.³⁷ Transferimet e parave të gatshme janë një formë e pagesave stimuluese emergjente që mund të ofrohen përmes një distribuimi ose përmes kësteve të shumëfishta me kalimin e kohës. Në mënyrë tipike, në një krizë, veçanërisht ajo që ndikon në industri specifike ose detyron papunësinë në sektorë të veçantë, më shumë njerëz bëhen të kualifikuar për ndihmë. Prandaj, pagesat përmes transferimeve e zvogëlojnë efektin e një ndryshimi në PBB-në reale në të ardhurat personale që të mund të harxhohen dhe ndihmojnë në izolimin e familjeve nga ndikimi i emergjencës. Edhe tatimet mbi të ardhurat kanë këtë efekt. Në mënyrë tipike, deri sa të ardhurat bien, njerëzit paguajnë më pak tatime mbi të ardhurat. Në disa raste, individët marrin benefite për papunësi, të cilat mund t'i nënshtrohen tatimit federal dhe/ose nën-kombëtar. Individët gjithashtu përkohësisht mund të pezullojnë pagimin e taksave. Veprimet e tilla referohen gjithashtu si **stabilizues automatikë**, të cilat synojnë të rrisin ose ulin PBB-në për shkak të ndryshimeve në situatën ekonomike të një vendi.³⁸

Ndërsa ekonomitë shërohen nga pandemia KOVID-19, vendeve mund t'iu duhet të rivlerësojnë dhe gradualisht të relaksojnë masat e ndihmës në varësi të ndryshimit të disponueshmërisë së burimeve. Kontrolli parlamentar do të jetë kritik në këto momente për të vlerësuar heqjen ose rregullimin e masave të tilla, në mënyrë që rikuperimi i mëtejshëm të mos rrezikohet. Bërësit e politikave duhet të kenë parasysh se kriza KOVID-19 nuk është e drejtpërdrejtë dhe se rikuperimi mund të mos jetë i qetë. Nëse masat e emergjencës hiqen para kohe, kjo mund të rezultojë në probleme të aftësisë paguese për individët dhe bizneset. Prandaj, parlamentet duhet të synojnë të monitorojnë, koordinojnë dhe rregullojnë në mënyrë aktive masat, kur është e nevojshme deri sa zgjat pandemia.

III. PROJEKTIMI I POLITIKAVE FISKALE GJATË NJË SITUATE EMERGJENTE

Për shkak të shpejtësisë me të cilën COVID-19 ndikoi në ekonominë globale, shumë vende u detyruan që në mënyrë të shpejtë të miratojnë rregulla të reja dhe të nxjerrin ligje për të lejuar qasje të jashtëzakonshme dhe inovative për të adresuar vështirësitë ekonomike të shkaktuara nga pandemia. Në të njëjtën kohë, institucionet legislative dhe publike, në përgjithësi, u detyruan të përshtatnin punën e tyre në përputhje me protokollin e sigurisë shëndetësore. Në disa raste, parlamentet ia deleguan kompetencën e tyre ligjvënëse, ekzekutiv. Disa parlamenteve të caktuara, kompetencat e tilla ua kishte uzurpuar pushteti ekzekutiv. Të tjerët, e mbajtën autoritetin e tyre legjislativ por e shpejtuan miratimin e buxheteve të shtetit dhe politikave të tjera ekonomike. Për një përmbledhje të hollësishme të masave të ndërmarra nga parlamentet për t'iu përshtatur pandemisë, duke pasur parasysh mënyrat e ndryshme në të cilat qeveritë reagojnë në muajt fillestarë të pandemisë, ju lutemi referojuni dokumentit të HDP-SDC të zhvilluar mbi adaptimet parlamentare gjatë COVID-19, me titull: *Parlamentet i përgjigjen pandemisë: Mësimet e nxjerra për planifikim emergjent*.

Miratimi i buxhetit

Duke pasur parasysh ashpërsinë dhe shpejtësinë e ndryshme me të cilat një krizë mund të ndikojë në ekonominë e një vendi, përgjigjet e politikës buxhetore duhet t'i japin prioritet çështjeve të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatmesme. Situata e krizës paraqet një sfidë të kufizuar kohore, shpesh e përballur nga nevoja për masa të jashtëzakonshme buxhetore të cilat ndihmojnë në zbutjen e ndikimit negativ ekonomik të krizës në fjalë. Në këto skenarë, pritet që parlamenti të përdorë fuqinë e tij përfaqësuese dhe mbikëqyrëse për të siguruar në radhë të parë nevojat e elektoratit të tij - veçanërisht ata të goditur më rëndë, të cilët shpesh janë gra dhe komunitete të tjera të marginalizuara dhe të cenuara - që adresohen përmes veprimeve emergjente.



(Harare, Zimbabve, 16 korrik 2020). Ministri i Financave dhe i Zhvillimit Ekonomik Mthuli Ncube arrin në parlament për të dorëzuar buxhetin afatmesëm dhe deklaratinë për rishikim ekonomik. Burimi: Wanda / Zinhua / Gettyimages.com

Financimi, si një përgjigje ndaj një situate emergjente, si përgjigje e krizës, mund të autorizohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë përmes:

- Procesit ekzistues buxhetor (nëse është në përputhje me afatin kohor të procesit të buxhetit kombëtar);
- Procesit plotësues buxhetor;
- Dispozitës brenda një veprimi emergjent, ose;
- Përdorimit të fondeve rezervë emergjente.

Siç u diskutua më parë, parlamentet duhet të kuptojnë nevojat akute të qytetarëve menjëherë pas një krize. Në varësi të natyrës së krizës në fjalë, kjo mund të kërkojë një ndihmë humanitare ose mundësimin e dispozitave të cilat rrisin qasjen ndaj shërbimeve dhe mallrave mbi baza emergjente.


Cikli buxhetor

Parlamentet mund të mbledhin informata dhe mendime nga grupet publike dhe grupet e interesit

- Ndihmojnë pushtetin ekzekutiv në formimin e buxhetit

Parlamentet dhe institucionet më të larta të auditimit kryejnë auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë

- identifikojnë dobësitë
- rekomendojnë ndryshimet
- certifikojnë kontot për të siguruar një bazë



Pushteti ekzekutiv ia prezanton propozim-buxhetin parlamentit

- Shqyrtohet nga komisionet e posaçme ligjvënëse
- Ndryshime të mundshme, buxheti paraqitet në seancë plenare për miratim

Parlamenti dhe komisionet e tij të përhershme monitorojnë realizimin e buxhetit

- Pyetje ndaj ministrave, misionet vëzhguese

Në planin afatshkurtër dhe afatmesëm, parlamentet doemos duhet të punojnë në kuptimin e nevojave të individëve në muajt që pasojnë, për shembull, për të siguruar që individët, familjet dhe bizneset të kenë fluks të mjaftueshëm parash për të ruajtur aktivitetin ekonomik, derisa gjithashtu përpiqen që të mbajnë nivelet e punësimit sa më afër që është e mundur me nivelet para krizës. Në të gjithë skenarët, është e rëndësishme që parlamentet të punojnë me degën ekzekutive për të miratuar politika ekonomike, të cilat janë përshtatur ndaj krizës në zhvillim. Është veçanërisht e rëndësishme që qeveritë të përdorin një proces transparent të negociatave për buxhetin në raste të emergjencës - veçanërisht në situata si ato të paraqitura nga KOVID-19, ku distancimi social shpesh ndaloi diskutimet personale ose ato të hapura për publikun mbi politikatat - për të siguruar që paratë janë të llogaritura dhe që arrijnë shpejt deri tek përfituesit e synuar.

Shfrytëzimi i procesit të buxhetit kombëtar për të vendosur financimin në situatat emergjente

Shumica e qeverive kanë një proces të kufizuar kohor për buxhetin vjetor, që kërkon veprime specifike ekzekutive dhe legislative. Në varësi të natyrës dhe kohës së një krize të caktuar, shteti mund të vijë në situatë të përdorë procesin e tij të buxhetit vjetor për të miratuar masa emergjente. Një buxhet kombëtar nuk është vetëm një regjistër i llogarive i cili përdoret për të vendosur alokimet vjetore të burimeve, por gjithashtu është një pasqyrë e prioriteteve të politikave publike, që kërkon angazhimin e qytetarëve përmes një procesi transparent dhe të arritshëm që lejon komunikimin e dyanshëm midis ligjvënësve dhe qytetarëve.

Gjatë gjithë pandemisë KOVID-19, varësisht nga afati kohor relativ në të cilin qeveritë po ekzekutonin prioritetet e tyre vjetore të buxhetit, shumë qeveri u larguan nga prioritetet e tyre normale të buxhetit pasi që pandemia kërkonte përshtatje për të ndihmuar mbështetjen e emergjencave dhe stimulimin për komunitetet e goditura rëndë. Për shembull, në **Australi**, **Kanada** dhe në **Mbretërinë e Bashkuar (MB)**, procesi i zakonshëm i planifikimit të buxhetit për vitin fiskal përkohësisht u la mënjanë për të adresuar nevojat e menjëhershme të jashtëzakonshme të alokimit të buxhetit që dolën në pah nga pandemia.³⁹

Konsiderata të rëndësishme në miratimin e dispozitave buxhetore në raste emergjente

Kur merret parasysh përdorimi i buxhetit të një vendi, si një mjet për ndihmë emergjente gjatë një krize, shqyrtimi legjislativ para miratimit të tij dhe mbikëqyrja gjatë gjithë zbatimit të tij është integrale për të mbështetur transparencën dhe për të siguruar një zbatim efektiv të shërbimeve qeveritare. Parlamentet kanë një rol themelor në miratimin e vendimeve buxhetore, që përfshin informatat e

qytetarëve dhe që varen nga fondet qeveritare për shpenzimet e vazhdueshme operative - veçanërisht gjatë një krize që ndikon në ekonomi, siç është KOVID-19.

Për shembull, në fillim të vitit 2020, **Franca** ishte dëshmitare që Kuvendi Kombëtar (Dhoma e Ulët e parlamentit) miratoi një buxhet emergjent që përfshinte planin e qeverisë prej 110 miliardë euro (120 miliardë dollarë amerikanë) për të shpëtuar ekonominë nga kolapsi lidhur me virusin. Buxheti gjithashtu përfshinte shpërblime për stafin mjekësor, fonde për të ndihmuar punëtorët dhe familjet në vështirësi dhe ndihma për bizneset, duke përfshirë industrinë strategjike si aviacionin dhe prodhimin e makinave.⁴⁰

Veçanërisht në një skenar krize, debati mbi buxhetin është gjithashtu një moment kritik për deputetët për të miratuar politika që adresojnë shqetësimet e komuniteteve të cënueshme, veçanërisht të grave, të rinjve, individëve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara. Në rastin e pandemisë, kjo përfshinte gjithashtu punëtorët në vijat e para si dhe të punësuarit në shëndetësi. Buxhetet që përfshijnë vetëdijesim për nevojat e atyre komuniteteve më të goditura gjatë një krize pasqyrojnë prioritetet e një vendi në atë moment të veçantë.

Për më tepër, një buxhetim efektiv dhe inkluziv kombëtar kërkon mekanizma për kontroll të buxhetit, siç janë dispozitat e inkuorpuara brenda legjislativitetit që përcaktojnë kërkesat për auditimet dhe rishikimet e burimeve. Më tej, masat




(Uashington, DC, 16 mars, 2020). Një ambulancë është e parkuar në sheshin jashtë Kapitolit të SHBA-ve 16 mars 2020 në Uashington, DC. Senati u kthye në detyrë pas fundjavës për të miratuar projekt-ligjin e ndihmës për koronavirusin që ishte miratuar në Dhomën e Përfaqësuesve. Legjislativi në projektligjin e Dhomës së Përfaqësuesve përfshin disa dispozita si të munguarit nga puna me pagesë dhe testimin falas për KOVID-19. Burimi: Drew Angerer / Gettyimages.com

e mbikëqyrjes do të kërkohen për të siguruar që qeveria do t'i përmbushë premtimet brenda një afati të caktuar kohor dhe se ka vendosur alternativa për qytetarët të që kërkojnë përjashtime ose kanë nevoja të përkohshme gjatë dhe pas krizës. Praktikrat e tjera më të mira të buxhetit, veçanërisht në skenarët e krizave, përfshijnë **teknikat për buxhetim inkluziv dhe me ndjeshmëri gjinore**, në të cilat prioritetet buxhetore marrin në konsideratë ndikimet disproporcionale të krizave mbi gratë dhe komunitetet e tjera të marginalizuara.

Kontrolli efektiv parlamentar gjithashtu kërkon bashkëpunim të ngushtë me **institucionet e larta të pavarura të auditimit (SAI)**, shumë prej të cilave janë dëshmuar si kyç në sigurimin e rishikimeve të pavarura mbi shpenzimet qeveritare gjatë krizës. Për shembull, në **Peru**, Zyra e Kontrolluesit të Përgjithshëm (CGR) krijoi Grupin e Menaxhimit të Emergjencave me një qëllim për të verifikuar prokurimin dhe shpërndarjen e mallrave brenda kontekstit të mbikëqyrjes epidemiologjike gjatë KOVID-19. Si pjesë e veprimeve të kontrollit, CGR ka shoqëruar figura të ndryshme publike në proceset e prokurimit lidhur me burimet e pandemisë, për ta bërë ekzekutimin e programit më transparent. Një shpallje e shpejtë u zhvillua që në fillim të pandemisë në mënyrë që Kongresi Peruan do të miratonte ligjin për të lejuar kontrollin e njëkohshëm të fondeve publike të përdorura nga autoritetet përballë emergjencës.⁴¹

Sigurimi i masave efektive të vëzhgimit brenda faturave të buxhetit ka fituar një rëndësi të veçantë gjatë KOVID-19, veçanërisht pasi qeveritë kanë futur masa të fuqishme për të ndaluar përhapjen e virusit dhe për të zbutur ndikimin e tij negativ në ekonomi. Prandaj, është e rëndësishme që parlamentet të angazhohen në negociata para-buxhetore para miratimit të tij. Për shembull, Komisioni i mbikëqyrjes buxhetore të parlamentit të **Irlandës** publikoi një raport para-buxhetor me një numër rekomandimesh që duhen konsideruar nga qeveria në lidhje me masat KOVID-19.⁴² Së fundi, siç u diskutua më herët, është e rëndësishme për parlamentet të shfrytëzojnë procesin buxhetor, veçanërisht gjatë një mjedisi të krizës, për të marrë parasysh prioritetet afatgjata fiskale, të tilla si ato që adresojnë objektivat e inflacionit, normat e papunësisë dhe nivelet e borxhit/deficitit derisa të qetësohet kriza.

Pyetjet kryesore për t'u marrë në konsideratë:



- *Çfarë procedurash dhe kompetencash i ka parlamenti për të kryer konsultime para-buxhetore me qytetarë të ndryshëm dhe shoqërinë civile, për të mbështetur një proces të pjesëmarrjes në formulimin e buxhetit?*
- *Cilat informacione dhe analiza kërkojnë deputetët dhe komisionet për të qenë në gjendje të shqyrtojnë thelbësisht buxhetin vjetor të shtetit, para miratimit nga parlamenti? Si do të përgatiten informacione dhe analiza të tilla?*
- *Si mundet që parlamenti të ketë qasje në ekspertizë dhe perspektivat e qytetarëve të ndryshëm në përcaktimin e objektivave afatgjatë të politikës ekonomike?*

Udhëzime:



- *Vendosni komunikim të hershëm me ministrinë dhe organet e tjera buxhetore për të përfshirë kontributin parlamentar përpara prezantimit të buxhetit vjetor të shtetit për miratim në parlament.*
- *Planifikoni një buxhet më fleksibël dhe më të shkathët, i cili balancon nevojën që qeveritë të reagojnë shpejt dhe nevojën për një mbikëqyrje më të afërt të shpenzimeve gjatë ekzekutimit të buxhetit.*
- *Bëni presion për të komunikuar informacione lehtë të kuptueshme dhe të arritshme për përdoruesit në lidhje me dispozitat e buxhetit emergjent, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien si në aspektin e përmbajtjes së buxhetit ashtu edhe procesit të buxhetimit.*
-

IV. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NË KOHË TË KRIZËS

Parlamentet janë kyç në sigurimin e shpërndarjes efektive të resurseve emergjente në komunitetet që janë në nevojë. Mbiqëqyrja parlamentare e programeve dhe shërbimeve qeveritare është një nga funksionet themelore të legjislativave në të gjithë botën. Kjo pjesë ofron një përmbledhje të mjeteve specifike që janë në dispozicion të parlamenteve për të mirëmbajtur mbiqëqyrjen e veprimeve ekzekutive në një krizë, me qëllim për të siguruar që politikat fiskale dhe monetare janë vendosur në një mënyrë adekuate, të përgjegjshme dhe të barabartë. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se kriza KOVID-19 ka pasur implikime të shumta në "procesin e rregullt" të mbiqëqyrjes parlamentare.

KOVID-19 vazhdon të paraqesë sfida për parlamentet për të marrë një rol efektiv në shqyrtimin e shpenzimeve emergjente dhe, në disa raste, ka kufizuar aftësinë e parlamenteve për t'i mbajtur qeveritë përgjegjëse. Për shembull, në fillim të pandemisë, për të mobilizuar shpejt burimet e tyre, shumë vende përdorën **procedura të miratimit të shpejtë**,⁴³ **fonde jashtë buxhetit**,⁴⁴ ose autorizuan qeveritë ose krerët e shteteve për të dhënë dekrete emergjente. Përmes këtyre veprimeve, praktikat e zakonshme të mbiqëqyrjes - siç janë seancat dëgjimore të komisioneve, debatet legjislativ publike në televizion dhe periudhat për komente të qytetarëve - u neglizhuan ose u zvogëluan. Në kohë të krizave, qeveritë shpesh nuk arrijnë t'i japin përparësi përgjegjësisë dhe transparencës. Veçanërisht gjatë KOVID-19, ku distancimi shoqëror dhe kërkesat e tjera të sigurisë shëndetësore rezultuan në punë në distancë dhe zvogëluan tubimet publike, disa nga ekzekutivët përfituan nga ky mjedis i kufizuar për të miratuar masa emergjente pa mbiqëqyrje legjislativ. Përkundër sfidave të ndryshme, ka shumë shembuj të parlamenteve që ushtruan mbiqëqyrje efektive gjatë KOVID-19. Për shembull, në **Austri**, u krijua një nënkomision i posaçëm i Komisionit për Buxhet, përgjegjës për mbiqëqyrjen parlamentare dhe kontrollin e masave KOVID-19, pasi që deputetët dhanë vërejtje mbi mungesën e transparencës në përgjigjen emergjente të qeverisë.⁴⁵

Institucionet e Pavarura Fiskale (IFI) dhe trajtimi i KOVID-19 në vendet anëtare të OECD-së

Institucionet e pavarura fiskale (zyrat buxhetore parlamentare të pavarura dhe këshillat fiskalë ose IFI) janë krijuar në të gjithë OECD për të siguruar një analizë të pavarur të politikës fiskale dhe performancës për të promovuar transparencën, politika të shëndosha fiskale dhe financa të qëndrueshme publike gjatë dhe pas pandemisë. Për shumë vende të OECD-së, shkalla e ngadalësimit ekonomik dhe e mbështetjes emergjente për familjet dhe bizneset është më e madhja në historinë e kohës së paqes, duke tejkaluar goditjen ekonomike afatshkurtër dhe reagimin e politikës fiskale gjatë krizës financiare globale të vitit 2007, e cila rezultoi në IFI të sotme. Për IFI-të e krijuara brenda dekadës së fundit, pandemia KOVID-19 është kriza e parë me të cilën po përballen. IFI kanë reaguar shpejt që nga fillimi i krizës, duke siguruar analiza jetësore për palët e tyre të interesit. IFI që kanë publikuar deklarata mbi krizën, kanë qenë unanime në vlerësimet e tyre se reagimet e konsiderueshme fiskale ndaj krizës nga qeveritë janë të përshtatshme. Për shembull, analiza nga Zyra e Mbretërisë së Bashkuar për Përgjegjësi Buxhetore (OBR) vlerësoi se masat e marra tani, edhe pse të shtrenjta nga perspektiva e huamarrjes, do të kushtojnë më pak në planin afatgjatë sesa impakti nga qeveritë që nuk ndërrojnë asnjë veprim për të mbështetur ekonominë. Në të njëjtën kohë, IFI-të kanë paralajmëruar që sapo të mbarojë kriza, vendet do të duhet të sigurojnë që financat publike të kthehen në një rrugë të qëndrueshme. Po kështu, deri sa IFI punojnë për të vlerësuar planin ekonomik dhe fiskal, parlamentet në nivel global po merren me ndërprerje operationale që vijnë nga distancimi shoqëror dhe sëmundja. Për më tepër, një ndjenjë urgjence ka detyruar shumë parlamente që të modifikojnë procedurat e mbiqëqyrjes legjislativ në favor të përshpejtitimit të përgjigjes ndaj pandemisë.

Burimi: Institucionet e Pavarura Fiskale: Nxitja e Transparencës Fiskale dhe Llogaridhënies Gjatë

Pandemisë së Koronavirusit (KOVID-19), Përgjigjet e Politikave të OECD-së ndaj Koronavirusit (KOVID-19), (OECD, maj 2020), <https://www.oecd.org/coronavirus/përgjigjet-e-politikave-institucionet-e-pavarura-fiskale-qe-promovojne-transparencen-fiskale-dhe-përgjegjesisine-gjate-koronavirusit-kovid-19-pandemi-d853f8be/>

Në **Shtetet e Bashkuara** në mars 2020, me miratimin e legjislativitetit fillestar të ndihmave emergjente, Kongresi themeloi Komisionin e Kongresit për Mbiqëqyrje të Ndhmës së KOVID-19, i cili përfshinte kongresmenë dhe senatorë me një mandat për të monitoruar në mënyrë specifike shpërndarjen e kredive emergjente, garancitë e huas dhe investimet nga qeveria e SHBA-ve. Ishte mandatuar që të raportonte çdo 30 ditë në Senat dhe në Dhomën e Përfaqësuesve.⁴⁶

Në **Kenia**, publiku ngriti shqetësime në media në lidhje me potencialin e krijimit të mbeturinave dhe korrupsionit në alokimin e 250 miliardë shilingave (2.3 miliardë dollarë amerikanë) në financimin e veçantë të ndihmës kundër pandemisë. Si rezultat, Komisioni i Llogarive Publike të Kuvendit Kombëtar Kenian urdhëroi një kontroll forenzik të shpenzimeve dhe e urdhëroi auditorin e përgjithshëm që të raportonte para komisionit çdo dy javë me azhurnime mbi auditimin dhe rezultatet e tij.⁴⁷

Pasqyrë e mjeteve parlamentare për mbikëqyrje

Ekzistojnë një varg i mjeteve që parlamenti mund të përdorë për t'u angazhuar në mbikëqyrje efektive gjatë një krize:

- **Shtrimi i pyetjeve ndaj pushtetit ekzekutiv** u japin një mundësi deputetëve që të pyesin zyrtarët qeveritarë për çështje për të cilat ata janë përgjegjës gjatë një krize. Kjo mund të ndodhë gjatë një kohe të caktuar qoftë ditore, javore ose, në disa raste, mujore ose gjatë dëgjimeve të komisionit.
- **Interpelanca** është e drejta për të shqyrtuar aktivitetet e qeverisë, për të marrë në pyetje ministrat për të gjitha çështjet e veprimeve (e drejta e interpelancës) dhe për të kërkuar që të gjitha informacionet relevante dhe përkatëse që t'i ofrohen parlamentit.
- **Debatet plenare** kanë të bëjë me një seancë ku përfshihet tërë parlamenti, në të cilën të gjithë deputetët janë mbledhur dhe marrin pjesë në përputhje me rregullat në diskutimin e hapur dhe debatin për çështje me rëndësi për agjendën legjislative, me mundësinë për të shqyrtuar legjislacionin në pritje.⁴⁸
- **Mocion mosbesimi** është një pushtet i ndarë për parlamentet për të larguar një qeveri ose një ministër individual si një mjet mbikëqyrjeje që lejon legjislaturën të debatojë dhe të përcaktojë nëse veprimet e një ministri apo qeverie çojnë në largimin e tyre.⁴⁹
- **Mbikëqyrja nga komisionet** është një funksion thelbësor legjislativ që mundëson ligjvënësit të debatojnë në mënyrë të hapur dhe të ndryshojnë politikat përmes seancave dëgjimore dhe takimeve të punës. Seancat dëgjimore të komisioneve u ofrojnë parlamentarëve një mundësi për të dëgjuar nga dëshmitë ekzekutive në lidhje me zbatimin e politikave dhe shpërndarjen e burimeve. Në këtë drejtim, seancat dëgjimore të komisionit në lidhje me integritetin financiar dhe operacional gjatë një krize janë një mjet veçanërisht i rëndësishëm i mbikëqyrjes.
- **Miratimi i emërimeve në pushtetin ekzekutiv** siguron që parlamenti të ketë mbikëqyrje ndaj individëve të emëruar për postet kryesore ekonomike dhe fiskale, veçanërisht ata nga të cilët kërkohet të miratojnë financat gjatë një krize, të tilla si Banka Qendrore e një vendi. Qasje në kohë në informacionin e duhur dhe të saktë mbi shërbimet qeveritare, programet dhe llogaritë është kritike për mbikëqyrjen efektive dhe vendimmarrjen, veçanërisht akses në informacione specifike në lidhje me krizën.

Komisionet si mjet kritik në mbikëqyrjen efektive

Shumë nga pikat e përmendura më sipër bëhen të mundshme përmes komisioneve parlamentare. Edhe në kohërat më të mira, puna e komisioneve është kritike për mbikëqyrjen efektive legjislative. Nën një skenar krize, dhe gjatë COVID-19, puna e komisioneve ka qenë edhe më e rëndësishme. Aksionet e komisionit në përgjigje të COVID-19 ofron një shembull se si ky mekanizëm jetik parlamentar u përdor në mënyrë efektive, pavarësisht nga imponimi i punës në distancë dhe demonstroi se si mbikëqyrja mund të përshtatet me operacionet parlamentare virtuale. Për më tepër, për shkak se komisionet ofrojnë një mjet të shumanshëm për ushtrimin e mbikëqyrjes, pasi që deputetët kanë mundësinë shtesë për të pyetur dëshmitarët drejtpërdrejt dhe për të shfaqur ekspertizën e tyre në diskutimin pse dhe si duhet të vendoset një politikë, komisionet ofruan një forum kritik për vazhdimin e punës legjislative gjatë pandemisë.

Komisionet ofrojnë një lidhje jetike midis shpenzimeve masive fiskale të qeverisë në një periudhë shumë të shkurtër kohe dhe ruajtjes së funksionit parlamentar për mbikëqyrje për të siguruar që fondet e taksapaguesve të jenë shpenzuar mirë dhe të drejtohen drejt përfituesve të synuar (p.sh., individët dhe bizneset). Po kështu, mbikëqyrja mund të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, duke respektuar kufizimet për shëndetin dhe sigurinë publike të imponuara nga pandemia. Ka disa mënyra funksionimi në dispozicion të komisioneve për adresimin e kësaj sfide. Për shembull, **takimet virtuale të komisioneve** u përdorën në shumë parlamente në nivel global, për të vazhduar dëgjimet, takimet e punës dhe levat e tjera kyçe të mbikëqyrjes. Për shembull, në Kongresin e ShBA-ve, pas disa muajve debat mbi ligjshmërinë e seancave virtuale që në fund të fundit u lejuan përmes një ndryshimi në rregulloret e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit, kryetarët e komisioneve kanë përdorur platforma virtuale për të konfirmuar prezencën virtuale të ligjvënësve, për të dëgjuar dëshmi dhe për t'u angazhuar në debat mbi amendamentet në nismat e ndryshme kyçe legjislative.

Disa parlamente kanë mbajtur **takime hibride të komisioneve**, të cilat përfshijnë pjesëmarrje në distancë, të kombinuar me punën e komisionit me prezencë fizike, për të siguruar që distancat sociale dhe standardet e higjienës të mirëmbahen. Kjo metodë mund të jetë me vështirë në ndërtesat e vjetra që nuk kanë ventilim adekuat ose qasje në ajër të hapur nga dhomat e komisioneve ose ku kondicionimi artificial i ajrit është ose i padisponueshëm ose tepër i shtrenjtë për ta vendosur. Në **Tanzani**, për shembull, zyrat e parlamentit në Dodoma kanë pasur hapësirë të përshtatshme për të lejuar deputetët të takohen në seanca plenare të shkallëzuara, dhe veçmas për seancat individuale të komisioneve. Duke pasur parasysh klimën dhe mundësinë e kufizuar të kondicionimit të ajrit, sidoqoftë, vëmendje i kushtohet distancimit social, kontrolllet e temperaturës dhe infermierëve prezent në vend për të siguruar që ata që janë të infektuar ose në rrezik infektimi mund të kryejnë punën e tyre duke ruajtur shëndetin e tyre personal.⁵⁰



(Hamburg, Gjermani, 1 qershor 2021). Katharina Fegebank (Bündnis 90/Die Grünen - Aleanca 90/Të gjelbërit), Kryetare e dytë e bashkisë dhe Senator për Shkencë, Kërkim dhe Barazi, tregon me gisht drejt Andreas Dressel (SPD), Senator për Financa në Hamburg, para fillimit të debatit të përgjithshëm mbi buxhetin e dyfishitë 2021/22 në Parlamentin e Hamburgut. Burimi: Marcus Brandt / Gettyimages.com

Gjatë pandemisë, disa parlamente zgjodhën një tranzicion të përkohshëm në **komisione speciale të pandemisë** në vend të seancave plenare. Kjo qasje është përdorur në parlamentet që janë të kufizuara në mënyrë kushtetuese në mbajtjen e seancave plenare virtuale, por në ato raste ka qenë e lejuar që parlamentet të kryejnë mbikëqyrjen dhe funksionet e tyre përmes diskutimeve të komisionit. Një pengesë e kësaj qasjeje ka qenë që komisionet e tilla nuk mund të miratojnë legjislacion, pasi që kjo mund të bëhet vetëm në seancë plenare. Për shembull, në **Zelandën e Re**, Komisioni për përgjigje ndaj epidemisë u krijua në mars të viti 2020 për të shqyrtuar dhe raportuar në parlament për çështjet që lidhen me menaxhimin e epidemisë KOVID-19 nga qeveria. Ky komision ndërpartiak drejtohet nga kreu i opozitës dhe përbëhet nga 11 anëtarë në total, gjashtë prej të cilëve janë anëtarë të opozitës, me procedurat e komisionit të transmetuara drejtpërdrejt në mediat sociale dhe faqen e internetit të parlamentit.⁵¹ Disa parlamente tashmë kanë komisione të tilla drejtuese. Për shembull, në **Tunizi**, Asambleja Kombëtare ka një Byro të përhershme të Asamblesë që merr vendime operationale dhe procedurale. Kur filloi pandemia, Byrosë së Asamblesë iu deleguan kompetenca të jashtëzakonshme nga Asambleja Kombëtare, për të lejuar Byronë që të menaxhonte punën e parlamentit në mënyrë më efektive, duke përfshirë marrjen e vendimeve lidhur me seancat në distancë dhe votimin virtual.⁵²

Derisa pandemia ka ecur para, një numër parlamentesh të tjerë ose kanë ngarkuar komisione të përhershme, ose kanë zhvilluar komisione speciale apo ad hoc, për të kryer mbikëqyrjen e financimit nga qeveria dhe programet në lidhje me krizën. Në **Armeni**, Asambleja Kombëtare ra dakord të krijojë një komision të posaçëm për të rishikuar trajtimin e pandemisë nga qeveria. Edhe pse shumica e anëtarëve të komisionit ishin zyrtarë të qeverisë, kryetari ishte një deputet nga opozita.⁵³

Në varësi të llojit të komisionit dhe strukturës së tij, ato shpesh ofrojnë një forum jetik për qytetarët dhe shoqërinë civile që të angazhohen me deputetë, posaçërisht përmes dëshmimeve të ekspertëve dhe parashtrësive me shkrim dhe me gojë. Në veçanti, komisionet ofrojnë një mundësi për dëshmitarët nga shoqëria civile për të siguruar informacion dhe të dhëna në kohë reale në lidhje me mënyrën se si një krizë po ndikon dhe prek qytetarët e zakonshëm. Angazhimi i qytetarëve dhe i shoqërisë civile në forma të tilla të mbikëqyrjes është një konsideratë e rëndësishme gjatë krizave. Prosesi i angazhimit të qytetarëve dhe grupeve të qytetarëve duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojat e grupeve të nënpërfaqësuar dhe të marginalizuara. Gjatë dekadës së kaluar, një numër i parlamenteve në nivel global kanë njohur vlerën e qasjeve të hapura dhe transparente në procedurat e komisioneve. Për shembull, duke siguruar që të gjitha seancat dëgjimore dhe takimet e punës të transmetohen, përveç krijimit të qasjeve sistematike për ndarjen e të dhënave dhe informacionit, u mundëson qytetarëve që të kërkojnë llogari nga deputetët për vendimet e tyre. Pandemia përshpejtoi përkushtimet e tilla nga disa parlamente, derisa të tjerët luftuan për të përbushur pritjet e tyre. Për shembull, në **Shqipëri**, parlamenti veproi shpejt për të krijuar mbledhje virtuale të komisioneve të tij menjëherë pas shpalljes së pandemisë. Kjo mundësoi, që për herë të parë, qytetarët të kenë qasje në transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore të komisionit.⁵⁴

Pyetjet kryesore për t'u marrë në konsideratë:



- Si duhet të përshtaten mjetet mbikëqyrës për t'u siguruar që deputetët kanë kohë dhe burime të mjaftueshme për të monitoruar shpenzimet dhe aktivitetet e qeverisë?
- A ka nevojë për të vendosur rregulla ose struktura të veçanta brenda parlamentit për të siguruar që mbikëqyrja ekonomike mund të vazhdojë gjatë një krize të madhe siç është pandemia?
- Si mund të sigurohet një parlament që ka qasje në analiza ekonomike të pavarura dhe me cilësi të lartë kur aktivitetet e tij normale janë të kufizuara?

Udhëzime:



- Sigurohuni që deputetët dhe stafi parlamentar të kenë qasje të barabartë në infrastrukturën teknologjike për të punuar në distancë. Nëse janë të ngarkuar me përgjegjësinë e kujdesit, parlamentet duhet të sigurojnë që si deputetët, ashtu dhe stafi duhet të mbështeten dhe/ose të kompensohen në mënyrë adekuate.
- Ndërtoni partneritete të fuqishme dhe bashkëpunim me institucionet e pavarura të mbikëqyrjes për të siguruar një shkëmbim rutinor të informacionit në kryerjen e mbikëqyrjes së qeverisë për të siguruar që ka qasje në të dhënat ekonomike dhe fiskale për të informuar punën e komisioneve, të cilat janë duke kryer mbikëqyrje.
- Ndërtoni sisteme dhe procedura të qëndrueshme për t'u siguruar që informacioni vazhdon të jetë i qasshëm për deputetët dhe stafin edhe gjatë një emergjence, duke përfshirë bibliotekë të qëndrueshme, shërbimet kërkimore dhe analizat ekonomike/fiskale.
- Bëni prioritetizim në punën e parlamentit, veçanërisht gjatë muajve të parë të një emergjence, për të siguruar që puna kritike të mbeten me prioritet, duke përfshirë këtu edhe çështjet kryesore ekonomike dhe fiskale për mbikëqyrje nga komisionet.

Zyrat dhe agjencitë e mbikëqyrjes

Përveç komisioneve, legjislaturat duhet të punojnë me **institucionet e mbikëqyrjes që janë jashtë parlamentit** e që mund të ndihmojnë në sigurimin e mbikëqyrjes së saktë dhe me kohë të shpenzimeve qeveritare, përfshirë paratë e shpenzuara për shërbimet publike, financimin stimuluës dhe mbështetjen e bizneseve dhe individëve gjatë periudhave ekonomike dhe krizave sociale. Është veçanërisht e rëndësishme që parlamentet të kenë qasje në të dhënat e qeverisë, të cilat përshkruajnë shpenzimet dhe informacionet në lidhje me politikën fiskale dhe monetare të cilat janë zhvilluar për të siguruar resurset për emergjencën.

Parlamentet gjithashtu mund të punojnë për të forcuar mbikëqyrjen financiare gjatë hartimit të politikave, duke kërkuar që qeveria të raportojë mbi ndikimet e një ligji gjatë distribuimit, derisa kërkon që agjencitë dhe departamentet e tjera të mbikëqyrjes financiare sigurojnë të dhëna përkrahëse për të ndihmuar komisionet përkatëse (p.sh. Komisioni i Buxhetit dhe i Financave, Komisioni i Llogarive Publike) që të përcaktojnë rrjedhën e synuar të zbatimit të politikës pandemike në krahasim me fondet specifike të alokuara dhe të shpenzuara me kalimin e kohës. Agjencitë dhe departamentet e tilla të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave buxhetore përfshijnë Institutin Shtetëror të Auditimit (d.m.th. Auditorin e përgjithshëm; *Cour des Comptes*) ose një Komision të Mbikëqyrjes Ekonomike. Komisionet speciale, specifike për krizat mund të fuqizohen për të forcuar dhe fuqizuar institucionet ekzistuese të pavarura siç janë zyra e auditorit dhe vetë parlamenti, dhe gjithashtu mund të shikojnë për inovacione që janë specifike me krizën.

Ka një numër vendesh që kanë mjete efektive për të mbështetur funksionet e tyre të mbikëqyrjes në koordinim me agjencitë jashtë parlamenteve gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme. Në **Ganë**, opozita (pakica në parlament) ka kërkuar nga ushtruesit e detyrës së auditorit të

përgjithshëm të paraqesë në parlament llogaritë e audituara të qeverisë për vitin financiar 2019. Më tej, opozita gjithashtu kërkoi që auditori i përgjithshëm të publikojë raportet në përputhje me Kushtetutën e vitit 1992 të Ganës.⁵⁵ Auditori i përgjithshëm i **Bermuda-s** përgatiti një raport të hollësishëm të përgjigjes së qeverisë ndaj pandemisë, përfshirë përgjigjen e saj ekonomike ndaj krizës shëndetësore.⁵⁶ Raporti u paraqit në parlament dhe pritet që Komisioni i Llogarive Publike të shqyrtojë dhe t'i përgjigjet raportit.

Në **Brazil**, neni 71 i Kushtetutës përshkruan marrëdhëniet bashkëpunuese midis Gjykatës Federale të Auditimit dhe Kongresit.⁵⁷ Kongresit i është caktuar përgjegjësia sipas Kushtetutës për mbikëqyrjen e qeverisjes financiare në vend dhe ai mban autoritetin që të angazhojë Gjykatën Federale të Auditimit për të kryer një analizë të detajuar dhe auditim të shpenzimeve qeveritare dhe më pas të sigurojë raportim në Kongres. Kjo i mundëson Kongresit që të përcaktojë veprimet e duhura në lidhje me shpenzimet dhe programet problematike. Në prill të vitit 2021, Senati i Kongresit Brazilian përdori këtë autoritet për të krijuar një komision të posaçëm për të rishikuar veprimet dhe vendimet e qeverisë federale në lidhje me përgjigjen e tyre ndaj pandemisë.⁵⁸

Zyrat e Buxhetit Parlamentar (PBO) janë gjithashtu burime të rëndësishme në parlament. Ato shpesh shërbejnë si burime të brendshme, të cilat ofrojnë të dhëna financiare në kohë, të sakta, relevante dhe kontekstuale dhe raportim gjithëpërfshirës se sa fondet rrjedhin nga banka kombëtare ose thesari i një vendi ndaj bizneseve, komunave dhe individëve si rezultat i veprimeve të reagimit ndaj krizave. PBO shpesh janë agjenci të pavarura, të lidhura drejtpërdrejt me parlamentin dhe ofrojnë analiza teknike objektive dhe gjithëpërfshirëse të buxheteve. Ato mund të gjenerojnë informacion fillestar financiar për debat të informuar të qeverisë dhe diskutim më të gjerë publik lidhur me ndarjet buxhetore, veçanërisht gjatë periudhave të krizës. Në disa vende, të tilla si **Liberia** dhe **Maqedonia e Veriut**, PBO-të gjithashtu mbështesin ekspertë të brendshëm ekonomikë për të mbështetur ligjvënësit dhe stafin në zhvillimin e politikave të forta fiskale dhe monetare.

Për PBO-të që formulojnë të dhëna të papërpunuara në dokumente gjithëpërfshirëse të politikave buxhetore dhe i sigurojnë deputetëve në komisionet me përqendrim ekonomik me analiza plotësuese se si vendimet e politikave lidhen drejtpërdrejt me nivelin e financimit të siguruar në një buxhet vjetor, kjo është veçanërisht e rëndësishme kur një parlament përpiqet të formulojë një buxhet emergjent, në koordinim me ekzekutivin dhe brenda një afati kohor të shkurtër, sikur gjatë një skenari krize.

Shumica e zyrave buxhetore parlamentare kanë katër funksione thelbësore:

- Të sigurojnë parashikime të pavarura dhe objektive ekonomike në baza vjetore ose gjysmë-vjetore;
- Të paraqesin një vlerësim ose parashikim të pavarur, apo të veprojnë si një burim për të verifikuar dhe vërtetuar rritjen e parashikuar të qeverisë dhe ndikimin e trazirave ekonomike, të tilla si gjatë kohërave të reagimit ndaj krizës;
- Të sigurojnë një studim fillestar të kushteve aktuale ekonomike në situata të zakonshme dhe të jashtëzakonshme krize, dhe;
- Të sigurojnë analiza afatmesme dhe afatgjata të tendencave dhe treguesve ekonomikë, veçanërisht kur një parlament reagon ndaj një krize, ndërsa ende shikon drejt rimëkëmbjes ekonomike përfundimtare.

Për shembull, **PBO-ja në Afrikën e Jugut** i ndihmoi qeverisë në sigurimin e informacionit specifik mbi zbatimin e paketës sociale dhe ekonomike, të prezantuar për të zvogëluar ndikimin e COVID-19. PBO gjithashtu ndërveproi me anëtarët e Komisionit të Financave për të këshilluar që mbështetja shtesë për familjet dhe bizneset do të ishte e nevojshme në muajt në vazhdim, në mënyrë që të sjellë rritjen ekonomike dhe prodhimin në nivelet para pandemisë. Duke përdorur analizën statistikore dhe të dhënave, PBO i dha parlamentit dhe ekzekutivit informacionin përkatës për të mbështetur planin e paketës së ndihmave dhe për të inkurajuar rimëkëmbjen ekonomike derisa pandemia tërhiqet me rritjen e numrave të të vaksinuarve dhe kthimin gradual të aktivitetit ekonomik në "normale".⁵⁹


Lidhur me kapacitetin e PBO-së për të siguruar parlamentin me informacione të duhura dhe me kohë në mbarë vendin, dhe në interes të lejimit të një përgjigje të shpejtë të informuar ndaj një krize, **PBO në Parlamentin Australian** iu ofron deputetëve dhe atyre në komisionet një vlerësim të qëndrueshmërisë fiskale të vendit dhe sfidat buxhetore si rezultat i pandemisë si dhe në nivelet kombëtare dhe nën-kombëtare (shtetërore dhe territoriale). Këto raporte shqyrtojnë të ardhurat, shpenzimet, investimet kapitale neto, vlerën financiare neto dhe pozicionin neto të borxhit në të gjitha nivelet e qeverisë Australiane. Ato ofrojnë një azhurnim të opinionit fiskal kombëtar, bazuar në azhurnimet e buxhetit të komonuelthit dhe qeverisë shtetërore, derisa vendi gradualisht rikuperohet nga ndikimi i rëndë negativ ekonomik i krizës aktuale të pandemisë.⁶⁰

Pyetjet kryesore për t'u marrë në konsideratë:



- Cfarë kapaciteti dhe ekspertizë teknike mund të marrë parlamenti nga institucionet e tjera të mbikëqyrjes për të mbështetur mbikëqyrjen e tyre të çështjeve ekonomike dhe fiskale?
- Si mund të përdorin teknologjinë informatike parlamentet, komisionet dhe deputetët individualë për të siguruar një qasje më të madhe ndaj të dhënave fiskale dhe ekonomike nga qeveria?
- A ka nevojë për procedura të veçanta ose angazhime ad hoc me institucionet e mbikëqyrjes, gjatë një emergjence, për të siguruar një koordinim dhe mbikëqyrje efektive?

Udhëzime:



- Vendosni një strategji afatgjate, shumë-vjeçare të zhvillimit mbi tranzicionin digjital të parlamentit për të siguruar që kjo infrastrukturë e re është e përqendruar në mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve dhe programeve qeveritare.
- Mendoni se si Buxheti dhe Financat, Llogaritë Publike ose komisionet e tjera të ngjashme të parlamentit tuaj mund të krijojnë një marrëdhënie pune të fuqishme dhe të besueshme me auditorin shtetëror, për të siguruar që puna e tyre është e mirë-koordinuar dhe ekspertiza teknike është në dispozicion të komisionit derisa kryen mbikëqyrjen.
- Mendoni se si Parlamenti mund të krijojë dhe të mbajë kapacitetin brenda institucionit, për të kryer analiza të thella ekonomike dhe fiskale përmes shërbimeve të zgjeruara kërkimore ose të mbështetjes së dedikuar analitike, siç është një zyrë buxhetore.

Qasja në kapacitetin e shoqërisë civile për të kryer mbikëqyrje

Siç është përmendur edhe më herët në këtë udhëzues, shoqëria civile, përmes organizatave të shoqërisë civile (OShC) dhe organizatave joqeveritare (OJQ), luan një rol jetik dhe të rëndësishëm në sigurimin që deputetët, komisionet dhe parlamenti, si një tërësi, janë të pajisur me informacione të sakta, reale dhe me kohë, lidhur me mënyrën e shpenzimit të fondeve qeveritare. Angazhimi i shoqërisë civile është gjithashtu thelbësor për të siguruar që shpenzimet e synuara të arrijnë komunitetet e goditura rëndë gjatë një krize; prandaj, ata informojnë veprimet legjislativë për të kryer një mbikëqyrje efektive të veprimeve ekzekutive.

Linjat e komunikimit me shoqërinë civile, duke përdorur teknologjinë e disponueshme (madje edhe nëse është vetëm një telefonatë ose mesazh përmes telefonit celular) është një kanal i rëndësishëm për mbikëqyrjen fiskale të vazhdueshme gjatë një krize. Të dhënat joformale të mbledhura përmes bisedës dhe mesazheve mund të plotësohen me pika të të dhënave periodike të mbledhura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në një mënyrë më të zyrtarizuar, si pjesë e sondazheve periodike, raporteve dhe të komunikimit me komunitetin, siç dëshmohet në vendet ku ky proces vazhdoi pavarësisht nga pandemia e KOVID-19.

Ndërtimi i partneriteteve të fuqishme me OShC-të mund të lejojë një parlament të bashkëpunojë me ato organizata për të angazhuar publikun dhe për të grumbulluar mendime që më pas i paraqiten parlamentit gjatë punës së tij të vazhdueshme për faturat e shpenzimeve dhe si pjesë e mbikëqyrjes fiskale. Në Kenia, "Mzalendo" është një OShC që ka punuar disa vite në monitorimin e punës së Asamblesë Kombëtare të Kenisë dhe Senatit. Me nevojën për të punuar ndryshe në vitin 2020, OShC-ja ka zhvendosur pjesën më të madhe të punës së saj në internet, ku vazhdon të informojë qytetarët dhe mbledh mendimet e tyre mbi punën aktuale të parlamentit.⁶¹

Në **Pakistan**, Rrjeti i Zgjedhjeve të Lira dhe të Drejta është një OShC që monitoron qeverisjen që ka përdorur rrjetin e saj të aktivistëve për të mbledhur të dhëna për përhapjen e KOVID-19 në vend. Që nga fillimi i vitit 2021, OShC-ja ka prodhuar raporte mujore që kanë përfshirë një analizë të përgjigjeve legjislativë dhe fiskale nga nivele të ndryshme të qeverisë ndaj pandemisë. Ajo gjithashtu ka përdorur raportin e saj për të bërë presion ndaj parlamentit për të qenë më aktiv në mbikëqyrjen e tij të shpenzimeve qeveritare.⁶²

Në gusht të vitit 2020, kur puna e parlamentit të **Indisë** mbeti e ndërprerë për pesë muaj, një forum i OShC-ve, i njohur si *Jan Sarokar*, organizoi një seri virtuale të dialogjeve të politikave për të diskutuar çështjet kryesore në lidhje me politikën publike dhe programimin e qeverisë, të tilla si arsimit dhe ndryshimet klimatike. Në mungesë të një parlamenti funksional, forumi i OShC-ve punoi për të siguruar vazhdimin e një forme të mbikëqyrjes së qeverisë gjatë pandemisë.⁶³

OShC-të janë bërë edhe më inovative në dërgimin e mesazhit të tyre deputetëve dhe parlamenteve për t'u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet derisa vendimet e politikës fiskale po merren në emër të tyre. Në disa raste, ka pasur një lëvizje për të përdorur mjetet në internet. Në **Indonezi**, një numër i OShC-ve kombëtare u bashkuan dhe kanë bërë presion për dorëheqjen e ministrit të shëndetësisë mbi trajtimin e pandemisë përmes një peticioni në internet.⁶⁴ Në **Gjermani** dhe **Holandë**, me qëllim për të respektuar udhëzimet e shëndetit publik, grupet mjedisore janë përqendruar në avokimin në internet, por gjithashtu kanë përdorur protesta simbolike para parlamentit, për të mbështetur përpjekjet e tyre në internet.⁶⁵

Në përgjithësi, dhe siç është cekur në këtë udhëzues, qëllimi si për përfaqësuesit ashtu edhe për të përfaqësuarit është të sigurojnë që shpenzimi masiv i fondeve publike për të luftuar ndikimet negative sociale dhe ekonomike gjatë krizës aktuale është të sigurojë që vullneti i mirë i qenësishëm për të ndihmuar ata në nevojë në tërë një shoqëri të caktuar dhe në të gjithë globin përputhet me përgjegjësinë fiskale dhe llogaridhënien.

Pyetjet kryesore për t'u marrë në konsideratë:



- *Cfarë kapaciteti mund të përdorë parlamenti nga shoqëria civile për të siguruar analiza të pavarura, me cilësi të lartë dhe të hollësishme mbi politikën ekonomike dhe fiskale për të mbështetur mbikëqyrjen e shpenzimeve dhe programeve qeveritare?*
- *Si mundet që parlamenti të konceptojë marrëdhënien e tij me shoqërinë civile për të pasur qasje në njohuritë dhe kapacitetin e tij teknik për të mbështetur punën e tij mbikëqyrëse?*
- *A duhet që parlamenti të përqendrojë kapacitetin e tij teknik në mbështetjen e një ose dy komisioneve kryesore apo të përqendrohet në mbështetje të gjerë analitike për të gjitha komisionet dhe deputetët?*

Udhëzime:



- Identifikoni aktorët kryesorë të shoqërisë civile, duke përfshirë think tank-et dhe akademikët, të cilët kanë ekspertizë në politikën ekonomike dhe fiskale për të mundësuar që ekspertiza e tyre të mbështesë punën e parlamentit dhe komisioneve të tij.

Përdorimi i teknologjisë për të promovuar mbikëqyrjen

Teknologjia informatike (TI) është një lidhje jetike që e bën të mundur që deputetët dhe stafi i tyre, qytetarët dhe institucionet në tërësi të lidhen përmes procesit demokratik. Gjatë periudhave të krizës, dhe veçanërisht gjatë gjithë pandemisë KOVID-19, teknologjia ishte jetike për mirëmbajtjen e funksioneve legjislativë dhe angazhimin e qytetarëve në zhvillimin e masave të reagimit emergjent. Sidomos gjatë KOVID-19, TI bëri të mundur që parlamentet të kalonin në një funksionim në distancë dhe virtual. Teknologjia inovative lejon parlamentet të kryejnë punën e tyre dhe të mbajnë mbikëqyrje efektive, veçanërisht në situata emergjente. Gjatë KOVID-19, ato parlamente që veç më kishin infrastrukturë të shëndoshë digjitale, në kohën kur goditi pandemia, ishin në gjendje që më shpejtë të përshtaten me kushtet e pandemisë. Në të njëjtën kohë, teknologjia sjell rreziqet e saj, shumë prej të cilave u ekspozuan derisa zgjati pandemia.



(Bruksel, Belgjikë, 27 maj 2020). Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian, djathtas, mban një maskë mbrojtëse në fytyrë derisa fliste me Valdis Dombrovskis, nënkryetar i Komisionit Evropian, në sallën plenare të Parlamentit Evropian në Bruksel, Belgjikë.

Burimi: Vanden Wijngaert / Gettyimages.com

Së pari, pandemia nxori në pah një deficit në qasje të teknologjisë të deputetëve, veçanërisht grave dhe atyre nga zona të largëta që janë përballur me sfida të mëparshme në përdorimin e TI-së. Secili parlament gjithashtu duhej të merrte parasysh se si do të siguronte që të gjithë deputetët të kishin qasje në harduerin dhe softuerin e duhur, për të funksionuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në procedime. Përveç kësaj, u bë e qartë shpejt se adresimi i çështjeve të sigurisë - konfirmimi i deputetëve para votimit dhe parandalimi i sulmeve kibernetike - ishte kritike për kalimin e suksesshëm në një proces legjislativ më digjital.

Gjithashtu u bë e qartë se kërkohej zhvillimi i aftësive dhe mbështetje teknike për të siguruar që të gjithë deputetët të mund të hynin dhe të përdorin teknologjinë në mënyrë të barabartë. Veç tjerash, është e rëndësishme rritja e rrezikut të dhunës në internet dhe gjuhës së urrejtjes, për shkak të rritjes së mbështetjes në platformat online për komunikim, ndërveprim dhe angazhim në distancë. Për shembull, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara António Guterres theksoi se mediat sociale në internet dhe platformat e ndërveprimit në distancë të përdorura në nivel global gjatë pandemisë KOVID-19 kanë dhënë një mundësi që gjuha e urrejtjes të amplifikohet dhe të promovohet (shpesh në mënyrë anonime). Si zgjidhje e mundshme e sugjeruar është një përpjekje e bashkërenduar arsimore, qytetare, mediatike dhe politike (parlamentare) me qytetarët pasi që të tërhiqet pandemia për të inkurajuar një kthim në një diskurs shoqëror më të civilizuar dhe më tolerant në epokën post-pandemike.⁶⁶


Derisa parlamentet vlerësojnë se si ata u përshtatën ndaj pandemisë, kjo gjithashtu paraqet një mundësi për të shqyrtuar se si ata mund të ndërtojnë një qëndrueshmëri më të përhershme përmes teknologjisë inovative për të siguruar përgatitjen për emergjencat e ardhshme.

V. NDIKIMI GJINOR


Pandemia e COVID-19 në mënyrë jo proporcionale ka ndikuar negativisht ndaj grave në të gjithë botën. Kufizimi i kontakteve shoqërore dhe mbyllja e ambienteve për kujdes ndaj fëmijëve i kanë vendosur gratë në një pozitë të pasigurt, ku ato janë të detyruara të marrin përsipër një barrë më të madhe të punës së papaguar të kujdesit dhe të obligimeve shtëpiake, njëkohësisht duke menaxhuar punën në distancë ose nga shtëpia. Kjo ka dy pasoja indirekte. Pandemia ka zbuluar dobësitë ekonomike të shumë vendeve, gjë që i bëri gratë më të cenueshme, posaçërisht si pjesë e fuqisë punëtore.⁶⁷ Për gratë deputete, ekziston gjithashtu një dimension i shtuar i sfidës në punën e tyre.

Duke filluar me ndikimin ekonomik të emergjencës tek gratë në përgjithësi, tani ka prova të mjaftueshme për të vërejtur se gratë, në veçanti, janë goditur rëndë nga pandemia. Pavarësisht nga çështjet shëndetësore dhe sociale që po ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë gjatë pandemisë, ka shenja të qarta se ekonomia e përgjithshme e kombeve do të ndikohet negativisht nga urgjenca, si rezultat i ndikimit të saj tek gratë. Gratë kanë 1.8 herë më shumë gjasa të humbin punën gjatë një situatë emergjente.⁶⁸ Po aq i rëndësishëm është fakti që shumë gra, veçanërisht ato që kanë fëmijë të vegjël, po vendosin të largohen ose të zvogëlojnë përfshirjen e tyre në ekonominë e paguar.

Punëtorë që konsiderojnë të zbrasin gradën në karrierën e tyre por të mos e lënë fuqinë punëtore në vitin 2020, %



Punëtorë që konsiderojnë të lënë fuqinë punëtore në 2020, %



Burimi: Gratë në vendin e punës 2020, LeanIn.Org dhe McKinsey, 2020

Parlamentet duhet të kenë informacionin dhe të dhënat për të kuptuar këto sfida dhe ndikimin specifik të një krize mbi gratë. Për më tepër, është e rëndësishme të merret në konsideratë se sa krijuesit e politikave janë në rrjedha me çështjen e gjithë përfshirjes dhe shkallës në të cilën pabarazia ndikon në aftësinë e grave dhe personave të tjerë të nën-përfaqësuar për t'u angazhuar në mënyrë aktive, efektive dhe të plotë në procesin parlamentar.⁶⁹ Kjo së pari dhe më së shumti ka nevojë për të dhëna të mbledhura mbi ndikimin ekonomik dhe mbi matjet kryesore ekonomike, të ndara sipas gjinisë, për t'u siguruar që vendimmarrësit të kenë të dhënat e nevojshme për të marrë vendime korrekte. Parlamentet kanë nevojë për kapacitete për të mbledhur të dhëna të tilla, por gjithashtu duhet të sigurojnë që qeveria bën ndarjen e të dhënave që mbledh. Pa të dhëna të tilla, është e pamundur të shihet pamja e plotë ekonomike dhe, nga ana tjetër, nuk ka gjasa që të merren vendime të cilat do të adresojnë nevojat e burrave dhe grave në mënyrë të barabartë.

Ka shembuj se si parlamentet kanë modifikuar punën e tyre dhe e kanë përqendruar kapacitetin analitik në ndikimin e pandemisë tek gratë. Parlamenti Evropian ka prodhuar kërkime të porositura dhe ka siguruar informacion dhe të dhëna të lehta për t'u kuptuar mbi ndikimin e emergjencës në veçanti tek gratë.⁷⁰ Komisioni për të Drejtat e Grave të Parlamentit të BE-së ka organizuar seminare dhe ka kryer konsultime për të kuptuar më mirë ndikimin mbi gratë.⁷¹

Komisioni i Grave dhe i Barazive i Dhomës së Ulët në Mbretërinë e Bashkuar zhvilloi një hetim mbikëqyrës për ndikimin e pandemisë tek gratë. Komisioni zhvilloi konsultime të gjera dhe mori parasysh me shkrim nga grupe të shumta të shoqërisë civile. Duke u bazuar në provat

e mbledhura, komisioni prodhoi një raport që siguroi disa rekomandime për të përmirësuar reagimin ekonomik të qeverisë ndaj emergjencës. Parlamenti i **Skocisë** veprroi shpejt për të kuptuar ndikimin e pandemisë në grupet e marginalizuara. Në prill të vitit 2020, Komisioni i Barazisë dhe i të Drejtave të Njeriut në parlament filloi një hetim se cilat grupe ishin ndikuar në mënyrë disproporcionale nga emergjenca shëndetësore. Kjo përfshiu edhe kërkesën për prova dhe mbledhjen e të dhënave.⁷²

Të dhënat dhe analiza mund të vijnë nga burime të jashtme. Për shembull, në **Maqedoninë e Veriut**, UN Women në dhjetor të vitit 2020 prodhoi një vlerësim të shpejtë gjinor mbi ndikimin socio-ekonomik të pandemisë si tek burrat ashtu edhe tek gratë, duke siguruar të dhëna dhe analiza të ndara të cilat mund të përdoren nga deputetët në diskutimet e tyre.⁷³

Këta shembuj tregojnë vlerën e shtuar të parlamentit në procesin e përgjigjes ndaj pandemisë dhe se si të dhënat e reja, analizat dhe raportimi i bazuar në prova mund të ndikojnë në vendimet që merren në përgjigje ndaj emergjencës. Puna e komisioneve të përmendura më lart ishte po aq një fushatë avokimi për të ndikuar në ndryshimin e politikave fiskale të qeverisë, po aq sa ishte edhe një rishikim teknik i programeve dhe financimit.

Megjithatë është gjithashtu e rëndësishme të mendojmë se si programet individuale të krijuara për të lehtësuar vështirësitë ekonomike gjatë një emergjence janë krijuar për të qenë njëloj të dobishëm, si për burrat ashtu edhe për gratë. Në **Mongoli**, parlamenti dhe ekzekutivi vendosën një sërë ndërhyrjesh që siguruan që gratë të përfitonin në mënyrë të barabartë. Kjo përfshinte një përjashtim nga pagesa e taksave personale për punëtorët në sektorin privat, ku 45 për qind të përfituesve ishin gra. Një program i veçantë i krijuar për të ulur pagesat e biznesit në taksa të sigurimeve shoqërore rezultoi që 50 për qind të përfituesve të ishin gra.⁷⁴

Duke shkuar përtej ndikimit të pandemisë në gratë në përgjithësi, gjithashtu ka një nevojë për të marrë në konsideratë ndikimin e emergjencës te gratë deputete. Edhe para pandemisë, gratë deputete u përballën me sfida më të mëdha sesa homologët e tyre burra, të cilat janë përkeqësuar nga vetë kriza. Hulumtimet specifike që nga fillimi i pandemisë kanë nxjerrë në pah sfida të tilla të mëtejshme, të cilat vetëm bëhen më keq gjatë një emergjence. Hulumtimi identifikoi katër rreziqe në rritje ndaj pjesëmarrjes politike të grave dhe përfshirjes politike gjatë KOVID-19 duke përfshirë:

- Rritjen e pasigurisë ekonomike dhe kthimin në rolet tradicionale gjinore, duke kufizuar aftësinë dhe kohën që gratë të marrin pjesë në politikë;
- Mbështetjen më të madhe në praktikat joformale që mund të kufizojnë qasjen e grave në burimet e partive dhe financimin e fushatave elektorale;
- Pabarazinë në qasje në platformat në internet (siç është cekur në nën-seksionin III ((c)), dhe;
